



60 vjet të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Dr. Sali BASHOTA, Drejtor i BKUK-së

Në kujtesën e Kosovës, krahas të dhënave të tjera, që lidhen me lashtësinë, gjuhën, kulturën, identitetin etj., dëshmohet edhe për ekzistimin e institucionit të parë bibliotekar, i cili është themeluar në vitin 1944 në Prizren. Është pra, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në Prishtinë, institucion i cili kaloi nëpër disa faza të zhvillimit dhe të ndërprerjes, që sivjet kremton 60 vjetorin e themelimit.

Gjatë kësaj periudhe, faktet dëshmojnë për ndërprerjen e punës së institucionit, për ndryshimin e emrit, ndërsa në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, e përjetoi fazën më të rëndë të okupimit nga pushteti serb, madje edhe me asgjësimin e fondeve bibliotekare. Nga kujtesa e së kaluarës kosovare, pos anatemit dhe okupimit, megjithatë ky

institucion ka krijuar një traditë në zhvillimin dhe në avancimin e shkencës, edukimit, qytetërimit tonë, duke u bërë vend i shkrimeve dhe i librave, tempull i dijes dhe i kulturës. Po kështu, edhe pikë referimi në dhënien e rekomandimeve, udhëzimeve profesionale e standardeve të tjera, që kanë të bëjnë me botën e librit dhe me veprimtarinë bibliotekare.

Pra, përbrenda periudhës gjashtëdhjetëvjeçare Biblioteka Kombëtare dhe Universitare është ballafaquar me sfida të moçme dhe të reja në shumë drejtime. Mirëpo, gjithsesi, ka frymuar me veçantinë e saj autentike, duke prezantuar modelin kulturor të bibliotekarisë në Kosovë, mbështetur në përvojat dhe të arriturat bashkëkohore të bibliotekarisë në Amerikë dhe Evropë, madje viteve të fundit duke u inkuadruar edhe në informacionet më të fuqishme të komunikimit dhe të teknologjisë bashkëkohore, duke

projektuar një vizion të ri për misionin dhe rolin e bibliotekës në shekullin XXI, si dhe duke hapur një kapitull të ri në bibliotekarinë e Kosovës.

Institucionet e Kosovës, veçanërisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Zyra SHBA-ve në Prishtinë, në vitin 2002 dhe 2003, kanë krijuar një realitet të ri në procesin e zhvillimit dhe të funksionalizimit të shumë projekteve kapitale që kanë të bëjnë me të tashmen dhe të ardhmen e këtij institucioni. Kështu është arritur që të prezantohen idetë dhe konceptet më të përparuara që kanë të bëjnë me strategjinë, prioritetet dhe objektivat e bibliotekarisë në Kosovë.

Është vendi dhe rendi që t'i përmend vetëm disa nga rezultatet kryesore të BKUK-së, të arritura në periudhën 2002/2003.

/ vijon në faqen 2 /



/ vijon nga faqja 1 /

Organizimi veprimtarisë kulturore Java e Bibliotekës në Kosovë, e cila koincidon me Javën e Bibliotekës në SHBA, organizuar së bashku me Zyrën e SHBA-ve në Prishtinë, hapja e Qendrës Amerikane, nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet BKUK-së dhe Kompanisë Ex Libris-Aleph 500 dhe implementimi i sistemit të automatizuar bibliotekar, revizioni i koleksioneve bibliotekare, anëtarësimi i BKUK-së në Lidhjen e Bibliotekave Hulumtuese të Evropës (LIBER), themelimi i Qendrës Informative për Qeverisje Parlamentare, bashkë me UNDP (Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara) dhe Kuvendin e Kosovës, themelimi i Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, themelimi i Arkivit Medial, riaktivizimi i laboratorit për restaurimin dhe konservimin e materialit bibliotekar, pasurimi i fondeve (blerja, dhuratat, ekzemplari detyrueshëm etj.), themelimi i Dhomës së shkrimtarëve dhe personaliteteve të kulturës, themelimi i Fondacionit Miqtë e BKUK-së, qasja në publikimet elektronike, publikimet e BKUK-së, reforma dhe struktura e re organizative e shërbimeve të BKUK-së etj.

Gjithsesi, një kapitull i veçantë është edhe përmirësimi i infrastrukturës dhe i kushteve të punës për punonjësit dhe për shfrytëzuesit e fondeve bibliotekare.

Duke e forcuar rolin dhe misionin e zhvillimit të bibliotekarisë në relacione ndërkombëtare, BKUK ka arritur bashkëpunim të frytshëm me shumë biblioteka nacionale evropiane e më gjerë: Poloni, Shqipëri, Gjermani, Rumani, Turqi, Itali etj.

Gjithsesi, projektet e përbashkë-

ta, në inicimin dhe në zgjerimin e aktiviteteve, në radhë të parë, me Bibliotekën e Kongresit Amerikan dhe me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, si dhe me bibliotekat evropiane do të ndihmonin në krijimin e një strategjie afatgjatë për përparimin e bibliotekarisë, si dhe nevojën për shkëmbime kulturore me interes të përbashkët. Prandaj, bashkëpunimi me bibliotekat nacionale të vendeve të tjera, është një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e këtij institucioni.

BKUK është qendër e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, pastaj qendër e promovimit të kulturës kosovare, por edhe asaj botërore, si dhe qendër e zhvillimit të koleksioneve të veçanta që lidhen me historinë, kulturën, identitetin e Kosovës, duke i favorizuar librat e rrallë dhe dorëshkrimet me vlerë.

Në librin Plani Strategjik për Bibliotekën Kombëtare dhe për Bibliotekën Universitare, botuar nga BKUK dhe Zyra e SHBA-ve në Prishtinë, projekt i cili pritet të realizohet, ish drejtori i përkohshëm i BKUK-së Dr. Kenneth J. Oberembt, ndër të tjera, thotë: Biblioteka Kombëtare shikon nga e kaluara, ndërsa Biblioteka Universitare nga e ardhmja.

Në shenjë të krenimit të 60 vjetorit të BKUK-së, lirisht të thuhet se e kaluara dhe e ardhmja, mbështetje kryesore le të kenë kriterin e vlerave dhe të rezultateve. Dhe kështu, rritet misioni i Bibliotekës bashkë me pasurimin e fondeve, zhvillimin e koleksioneve, përsosmërinë e shërbimeve, teknologjinë moderne të komunikimit, bashkëpunimin ndërbibliotekar, qasjen e lirë në informata etj.

Dhe kështu rritet Tempulli i Dijes. Kujtesa dhe Vizioni i Kosovës.

Në këtë numër



Bibliotekat në epokën e informacionit dhe teknologjitë e reja.....	3
Nga komunikimi konvencional në komunikimin digjital.....	4
Bibliotekat dhe interneti.....	6
Interneti, qasje në informata globale?.....	8
Numri standard ndërkombëtar i serialeve (ISSN).....	12
Rëndësia e përdorimit të ISBN-së.....	15
Karta e të drejtave të bibliotekave.....	17



www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK, **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota, **Kryeredaktor:** Vehbi Miftari
Këshilli redaktues: Mr. Shukrie Rama, Bedri Gashi, Fazli Gajraku, **Lektor:** Muhamet Çitaku,
Realizimi kompjuterik: Hekuran Rexhepi, **Fotoreporter:** Bashkim Binaku
Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n, Prishtinë
Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940
E-mail: biblioteka@biblioteka-ks.org



Bibliotekat në epokën e informacionit dhe teknologjitë e reja

seminari, ligjëroi eksperti amerikan Grant Garden Harris. Në ditën e parë ai ligjëroi në temën "Sfida digjitale". Një pjesë e mirë e ligjëratës është vënë në funksion të shpalosjes së modelit strategjik digjital të Bibliotekës së Kongresit dhe në përshtatjen e kësaj strategjie edhe për bibliotekat e tjera.

Motivimi i aplikimit të metodologjive të reja digjitale dhe i kërkimeve të shpejta në sasi dhe cilësi të informacioneve, është trajtuar nga Grant Harris në mënyrë teorike dhe praktike. Elementet kryesore të ligjërimit të tij janë përqendruar në motivimin dhe frymëzimin i një stafi cilësor e të trajnuar, për të bartur barrën e informacioneve kulturore, arsimore, edukative e shkencore në epokën e sotme digjitale. Ndër trajtimet më interesante ishte edhe organizmi i sistemit të integruar bibliotekar, i cili përshatatet me Internetin dhe krijon një partneritet të pashkëputshëm informativ.

Sipas Harrisit, tiparet dhe pjesët e ndryshme të sistemit të integruar bibliotekar të një vendi, shpeshherë krijojnë probleme dhe janë zhgën-

gjyese, por duhet diskutuar haptas për efektivitetin e këtyre tipareve dhe të këtyre pjesëve, në mënyrë që ato të përmirësohen. Ndër të tjera, Grant Harris, trajtoi edhe probleme të ndryshme që ndërlidhen me Intranetin e Internetin dhe vënien e tyre në shërbim të informacioneve për përdoruesit.

Më 9 shtator, në bashkorganizim të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Shtëpisë së Librit dhe Komunikimit në Tiranë, është zhvilluar edhe konferenca me titull "Interneti i hapur, interneti komercial, periodiku elektronik dhe referencat digjitale". Në këtë konferencë, Harris u ndal te përdorimi sa më efikas i internetit në funksion të kërkimeve bibliografike, mediale dhe periodike.

Temat e ditës së dytë ishin më të ngjeshura. U ligjëruan dhe u paraqitën në projektor sferat e detyrave nga katalogu në rrjet dhe burimet e tjera të informacionit të Bibliotekës së Kongresit Amerikan. Gjatë dhe në përmbyllje të ligjëratave, Harris uroi dhe plasoi shumë mesazhe pune në drejtim të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

B. Gashi

Më 8 dhe 9 shtator 2004, në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë u mbajt seminari "Bibliotekat në epokën e informacionit dhe teknologjitë e reja". Ky seminar është bashkorganizuar nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Në të morën pjesë ekspertët e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë në Tiranë, përfaqësuesit e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës si dhe përfaqësuesit e bibliotekave publike, speciale dhe shkencore të Shqipërisë. BKUK-në e kanë përfaqësuar Gjon Berisha, Fazli Gajraku dhe Bedri Gashi.

Gjatë punimeve dyditëshe të këtij

Interneti, qasje në informatat globale?

Vehbi MIFTARI

Zhvillimi i teknologjive të reja informative e ka ndryshuar rrënjësisht formën e ofrimit të informatave. Sot, bibliotekat ofrojnë shërbimet e tyre përmes teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, duke përmbushur kërkesat e përdoruesve të tyre për qasje të lirë në katalogun elektronik edhe nga shtëpia, ose për të porositur materiale bibliotekare nga distanca. Ndryshimi i ofrimit të shërbimeve në biblioteka ka kushtëzuar edhe hartimin e legjislacionit të nevojshëm për të drejtën e qytetarëve për qasje të lirë në internet, si dhe hartimin e politikave të veçanta për zhvillimin e Teknologjive Informative (TI-ve) dhe aplikimin e tyre në biblioteka.

Në rrethanat e aplikimit të hovshëm të këtyre teknologjive informative nëpër biblioteka, shteti duhet të hartojë legjislacionin e nevojshëm për të siguruar aplikimin e drejtë të tyre në biblioteka, në mënyrë që përdoruesve të këtyre bibliotekave t'u garantohet e drejta për qasje të papenguar në informatat globale, ose që ata të mund t'ia ofrojnë idetë ose kulturën e tyre opinionit botëror. Ky legjislacion është i nevojshëm që të hartohet konform strategjisë shtetërore për zhvillimin e TI-ve, në mënyrë që legjislacioni i ofruar të jetë afatgjatë dhe të sigurojë vijueshmërinë e aplikimit të këtyre teknologjive në biblioteka. Për këtë arsye, shteti duhet të garantojë me ligj të drejtën e qytetarëve për qasje në informatat globale përmes internetit. Në Danimarkë, p.sh., e drejta e qasjes së lirë në internet është e rregulluar me Ligjin për Bibliotekat, dhe zhvillohet konform politikave të shtetit për zgjerimin e teknologjive informative (TI-ve). Sipas këtij ligji, qytetari danez ka të drejtë të ketë qasje të lirë në internet, kurse bibliotekat janë burim i rëndësishëm për përpjekjet e qeverisë për zhvillimin rrjetit për të gjithë qytetarët e saj.¹

Kosova nuk ka pasur deri vonë ndonjë politikë të veçantë për zhvillimin e TI-ve. Më 3 mars të vitit 2003 Mistrria e Shërbimeve Publike ka shpallur draftin e parë (i cili pritet të modifikohet) të strategjisë për zhvillimin e teknologjive informative në Kosovë (TIK), i cili paraqet pikësynimet e përcaktuara për përvijimin e një strategjie për shtrirjen e tyre në Qeverinë e Kosovës. Njëri nga katër synimet e kësaj strategjie është "qasja dhe shkëmbimi i informatave", me të cilin parashihet ngritja e

nivelit të qasjes në informata (dokumente zyrtare, materiale arkivore etj.), si dhe shkëmbimi më i lehtë dhe i papenguar i këtyre informatave. Po ashtu, më këtë strategji parashihet dhe ngritja e kapaciteteve (resurseve) humane për përdorimin e teknologjive të reja informative, me të cilin do të sigurohet një politikë e qëndrueshme shtetërore në krijimin dhe ruajtjen e resurseve njerëzore, të afta për t'i aplikuar në praktikë teknologjitë më të reja informative, përmes një "politike agresive të trajnimit".

Përpos strategjisë që hartohet dhe miratohet nga qeveria, e cila përfshin shtrirjen dhe aplikimin e teknologjive informative në të gjitha sferat e dijës dhe të kulturës njerëzore, është e domosdoshme që për aplikimin e tyre në biblioteka të hartohet legjislacioni i veçantë, ose që legjislacioni për bibliotekat të garantojë aplikimin e tyre në to. Kjo e drejtë e përdoruesve në burimet globale të informacionit duhet të jetë e garantuar me legjislacionin për bibliotekat për arsye se bibliotekat shërbejnë edhe si porta të informacionit. Përmes ofrimit të mundësive për qasje në internet për përdoruesit e tyre ato shërbejnë si "porta esenciale" të informimit, prandaj ofrimi i qasjes në internet në biblioteka është esencialisht, sidomos për kategoritë sociale ose etnike të përdoruesve të cilëve biblioteka u shërben si portë e vetme për të marrë informacione globale, ose për t'i paraqitur interesat, njohuritë dhe kulturën e tyre para tërë botës. Në vendet me politika të zhvilluara sociale qasja në internet është e pakufizuar për të gjithë qytetarët. Kështu, për shembull, biblioteka "Pompidu" e Parisit ka krijuar një një lidhëse (link) me qendrat për punësim, baza e të cilave konsultohet drejtpërdrejt nga përdoruesit e bibliotekës. Por, ekzistojnë edhe shumë shembuj të kufizimit të kësaj të drejte. Në Kubë, për shembull, gjatë vitit 2003 janë marrë një varg masash për pengimin e qasjes në internet.

Sidoqoftë, interneti paraqet jo vetëm mundësi për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bibliotekare, por edhe portë për qasje në informata. Ai shërben si medium i fuqishëm për të thithur informata globale, pa marrë parasysh kufijt. Në Ligjin për Bibliotekat, të miratuar më 2003 nga Kuvendi i Kosovës, nuk gjendet asnjë nen që e përcakton këtë të drejtë. Asnjëra nga bibliotekat publike në Kosovë nuk posedon me bazën e plotë të të dhënave ose me katalog elektronik. Kërkimi dhe ofrimi i infor-



matave bëhet ende në mënyrë manuale, kurse shërbimet janë të kufizuara. Në prill të vitit 2004, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar kontratë me kompaninë izraelite "Ex Libris" për ta instaluar sistemin e integruar bibliotekar "Aleph 500", me të cilin do të krijohet hallka e parë e rrjetit të bibliotekave në Kosovë, e me këtë do të përmirësohen dukshëm shërbimet bibliotekare dhe mundësitë e qytetarëve të Kosovës për të pasur qasje të lirë në informata përmes internetit. Por, krijimit të rrjetit bibliotekar do të duhej t'i paraprinin disa veprime paraprake:

- hartimi i Ligjit për Qasje në Internet;
- hartimi i politikave për zhvillimin e teknologjisë informative në biblioteka në harmoni me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e teknologjive të reja në vend;
- plotësimi i legjislacionit për bibliotekat, në mënyrë që të garantohet zbatimi i shërbimeve përmes teknologjive të reja informative.

Hapi i parë në garantimin e së drejtës së individit për qasje në internet, në Evropë është ndërmarrë më 1994, kur Komisioni Evropian hartoi raportin "Bangeman", i cili u shndërrua në plan për krijimin e një shoqërie globale të informacionit. Në bazë të këtyre politikave, vende të veçanta hartuan strategji për zhvillimin e TI-ve, ndër-sa bibliotekat e përkrahën përfshirjen e tyre në shërbimet bibliotekare. Në fakt, aplikimi i teknologjive të reja në biblioteka ka filluar shumë më herët, më 1963, kurse aplikimi i internetit në vitet '90 e transformoi përfundimisht konceptin për bibliotekat, të cilat u orientuan drejt krijimit të bibliotekave digjitale. Manifesti i IFLA-s për Internetin parashihte që e drejta e qasjes në internet është e drejtë themelore e përdoruesve të bibliotekave, dhe bënte thirrje për të pamundësuar censurimin e saj për shkaqe ideologjike, politike a religjioze, ose për shkak të barrierave ekonomike. Mirëpo, ky manifest njihte edhe të drejtën e stafit bibliotekar për të udhëzuar përdoruesit vetëm për përdorimin e informacionit cilësor, jofjes, në internet.

Përvoja e vendeve të zhvilluara ka treguar se aplikimi i teknologjive të reja informative krahas përparësive të mëdha që ka ofruar në përmirësimin e shërbimeve bibliotekare, ka ngritur edhe shumë dilema përsa i përket të drejtës së përdoruesve

të tyre për qasje në materialet elektronike. Ta zëmë, është ende e papërcaktuar nëse garantimi i të drejtës për qasje të lirë në internet nënkupton se ai (përdoruesi) mund të ketë qasje në të gjitha informtatat që i ofron interneti. Cilat janë të drejtat e bibliotekave në përzgjedhjen e materialeve që do t'i ofrohen qytetarëve? A mund të jenë pjesë e kësaj të drejte materialet pornografike ose violente? Garantimi i së drejtës së qasjes së lirë në informata përmes internetit do të duhej të kuptohej jo vetëm si përcaktim i së drejtës së qytetarit për qasje të lirë në internet, por edhe i së drejtës së bibliotekave për të zgjedhur materialin që do t'u ofrohet përdoruesve, në kuptimin e statusit të atij materiali. Pornografia nuk mund të jetë material i përdorshëm dhe shumë biblioteka gëzojnë të drejtën që këto materiale të mos i ofrojnë në shfrytëzim për përdoruesit.

Mirëpo, përdorimi ose kufizimi i përdorimit të këtyre materialeve duhet të përcaktohet me ligj. Ky ligj duhet të përcaktojë jo vetëm të drejtën për të ofruar qasje në informata përmes internetit, por edhe të drejtën e bibliotekave për dhënien në përdorim të materialeve të zgjedhura bibliotekare. Për shkak të mungesës së këtij ligji ose për shkak të keqinterpretimit të tij, në disa vende të Europës dhe në SHBA janë zhvilluar edhe procese gjyqësore për shkak të keqkuptimeve ose pretendimeve që përdoruesit në njërin anë, dhe bibliotekarët, në anën tjetër, kanë pasur karshi përdorimit të këtyre materialeve. Në disa vende bibliotekat kanë qenë të detyruara të krijojnë "teknologjinë filtruese" (edhe pse kjo ndonjëherë ka qenë kontestuar me gjyq, madje është quajtur edhe si shkelje e të drejtës së qytetarëve për të pasur qasje në diversitetin e shprehjes) për të pamundësuar që, fëmijët ta zëmë, në bibliotekat publike të kenë qasje në web faqet me përmbajtje pornografike.

Sidoqoftë, roli parësor i bibliotekave karshi internetit dhe përgjithësisht teknologjive të reja informative është krijimi i mundësive për qasje të lirë në informatat globale dhe në ekspozimin para botës të krijimtarisë personale. Mendoj se në vitet e ardhshme bibliotekat do të orientohen në dy drejtime themelore:

- krijimin e qasjes së lirë në informata përmes internetit për përdoruesit e tyre;
- aftësimin e tyre për përdorimin e këtyre teknologjive.

Përsa i përket krijimit të qasjes së lirë për të gjithë qytetarët në informata përmes teknologjive të reja, bibliotekat do të vazhdojnë të përballen me dilemën e madhe: çfarë nënkuptohet me qasje të lirë dhe çfarë materiale mund dhe duhet të cilësohen si materiale të përshtatshme për t'iu ofruar përdoruesve të tyre përmes internetit. A do të thotë kjo se të gjitha materialet duhet të lejohen të përdoren në bibliotekë? Apo, duhet që ato të përdorin "teknologjinë filtruese" për të parandaluar qasjen në informatat e dëmshme? Kjo do të mbetet preokupim i vazhdueshëm i bibliotekave.

Sa i përket aftësimin të përdoruesve për përdorimin e këtyre teknologjive në biblioteka, mendoj se bibliotekat, konform strategjisë për zhvillimin e TI-ve, do të shndërrohen në qendra për aftësimin e përdoruesve për përdorimin e teknologjive informative, me qëllim të realizimit të kërkimeve të tyre shkencore ose sociale. Të mos harrojmë, kërkesat sociale (për punë, ta zëmë), tashmë kanë filluar që të shtrohen nga biblioteka, përmes qasjes së drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të qendrave për punësim. Po ashtu, bibliotekat do të shndërrohen në qendra koordinuese për informata zyrtare (kujto vendimin për hapjen e Qendrës Informative të BKUK-së për Qeverisjen Parlamentare, e cila ofron qasje të drejtpërdrejtë në arkivin elektronik të Kuvendit të Kosovës, si hapi i parë, konkret, në aplikimin e kësaj praktike në bibliotekat në Kosovë).

Bibliotekat, sidomos ato publike, kanë për obligim që të kujdesen jo vetëm për sigurimin e informacioneve përmes internetit, por edhe për aftësimin e përdoruesve në kërkimin dhe përdorimin e tyre përmes teknologjive të reja informative. Kërkesa për krijimin e rrjetit të bibliotekave është kërkesë në rritje dhe të gjitha bibliotekat duhet të mendojnë të inkorporohen në rrjet, me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave e cila garanton informacion të plotë për materialet bibliotekare, si dhe për qasje në dokumente të ndryshme përmes internetit. Po ashtu, ato duhet të hulumtojnë dhe të garantojnë shërbime profesionale përmes internetit, duke krijuar strategji për përparimin e shërbimeve bibliotekare. Vetëm kështu, ato do të realizojnë të drejtën elementare të çdo individi për qasje të lirë në informata, duke përfshirë këtu edhe informatat zyrtare.

Nga komunikimi konvencional në komunikimin digjital

Bedri GASHI

Digjitalizimi i veprimtarisë bibliotekare në vetvete përmban një kurs shumë modern në krahasim me veprimtarinë e kaluar tradicionale. Futja dhe ndërtimi i komunikimit të digjitalizuar në një bibliotekë kombëtare është një proces dhe një punë madhore, të cilën e realizojnë ekipe të tëra profesionale.

Zhvillimet e sotme të teknologjisë informative që zbatohen nëpër bibliotekat e ndryshme të botës, tregojnë se niveli i komunikimit të kaluar nuk ka plotësuar nevojat e përdoruesve dhe se veprimtaria profesionale domosdo duhet të pasurohet me programe të nivelit të lartë botëror.

Aktualisht, në BKUK pritet futja e një programi të një niveli të lartë botëror. Këtë fat profesional e institu-

hedhja e të dhënave retrospektive, duke u bazuar në specifikat e veçanta të sektorëve dhe të shërbimeve, që veprojnë në kuadër të departamenteve të BKUK-së.

Organizimi i sistemit digjital të një biblioteke përbëhet prej një sërë çështjesh të ndërlukuara programore, në rastet kur ai aplikohet për herë të parë.

Domosdoshmërisht, operacionalizimi i ri programor i BKUK-së do të krijojë shkëputjen e imponuar nga metodat konvencionale të punës, me ç'rast të dhënat konvencionale do të pësojnë "një diskriminim pozitiv profesional". Kjo shkëputje dalton dhe varion nga roli dhe pesha profesionale e sektorëve dhe shërbimeve të departamenteve përkatëse.

E dhëna se komunikimi konvencional do të mbetet në një formë a në një tjetër, si

relikt i një kohe, për ne është një motivim i madh, sepse ky komunikim ka shkaktuar pasivitetin e proceseve profesionale në sistemin e përgjithshëm bibliotekar në Kosovë.

Për shkak se puna me depozitimet elektronike të fondeve dhe materialeve bibliotekare për ne është risi, preferohet që krahas depozitimit elektronik të mos ndërprehet procedura e përshkrimit bibliografik të skedarëve në dorëshkrim, për hir të ruajtjes së kësaj

trashëgimie të çmuar. Edhe bibliotekat më të avancuara kombëtare në botë e ruajnë në dorëshkrim skedarin e tyre, prandaj në bazë të kësaj të dhëne, zingjirët e çështjeve zbatuese, fillimisht, mund t'i trajtojmë si shkëputje të





pjesërishme nga metodat konvencionale të punës (skedarët) dhe si shkëputje totale të punës (punët pasuruese, klasifikuese, periodike, hulumtuese e të tjera).

Qysh në fillim, veprimtarinë e ardhshme të punës profesionale në BKUK mund ta ndajmë në metodologji gjysmëkonvencionale (me tendencë që kjo të tejkalohet në vazhdimësi), dhe në metodologji plotësisht të digjitalizuar. Pjesa më e madhe e veprimtarisë futet në metodologjinë e përkufizuar digjitale.

Me operimin digjital një pjesë e punëve pushojnë së vepruari, ndërsa të gjitha çështjet e tjera profesionale projektohen në staza afatshkurtra dhe afatmesme, kurse projektimi afatgjatë mund të quhet me një emër: proces.

Ç'mund të përfshijë projektimi kohor i një programi të tillë? Ndër çështjet e të sotmes dhe të së ardhmes, për komunikimet dhe shkëmbimet e informacioneve bibliotekare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, hyjnë: projektimi afatshkurtër që përfshin komunikimin e brendshëm të BKUK-së; projektimi afatmesëm që përfshin komunikimin e bibliotekave ndërkomunale dhe komunale të Kosovës; projektimi afatgjatë që përfshin komunikimin dhe shkëmbimin ndërmjet bibliotekave universitare, speciale, shkencore dhe

shkollore.

Vendet e tjera shërbehen me programe të ndryshme varësisht prej tipit të bibliotekës. Një program i një biblioteke kombëtare nuk mund të jetë funksional edhe për bibliotekat e tjera, ta zëmë, për bibliotekat speciale, por mund të merren pjesë të veçanta të tij. Por, mbi të gjitha, pretendimet profesionale duhet të jenë evidente, për gjetjen e mundësive për realizimin unik të programeve dhe qasjeve në bibliotekat e Kosovës.

E ardhmja sfidon përdoruesit dhe ofruesit e të dhënave për fondet dhe materialet e digjitalizuara bibliotekare, ndërsa sfida më e zëshme troket në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Nga përparësitë që ofron komunikimi digjital në bibliotekë, mund të përfitojnë dhe të kenë qasje të drejtpërdrejta edhe institucionet e tjera kulturore, siç janë arkivat dhe muzetë, sepse fondet e BKUK-së përmbajnë trashëgiminë e koleksioneve të artit, kulturës, shkrimeve të reja e të vjetra.

Me interes të jashtëzakonshëm do të ishte digjitalizimi vizuel i koleksioneve të rralla dhe të vjetra, me ç'rast përdoruesit do ta kishin më të lehtë hyrjen në një informacion të rrallë a të vjetër trashëgimie, krahasuar me përdorimin tradicional, që përmban kushtezyet e veta.

Të përdoruesi i sotëm luan rol edhe përmbajtja vizuale e imazheve dhe e pamjeve nga ngjarjet e mëdha e të dendura kombëtare. Edhe këtu Kosova, konkretisht, BKUK-ja si institucion bartës i trashëgimisë së saj, ka çfarë t'u ofrojë përdoruesve, sepse me luftën e fundit ajo ka hyrë në historinë botërore.

Për të gjitha këto, peshë të veçantë kanë aftësimi dhe ngritja e kuadrit bibliotekar. Ngritja dhe aftësimi i kuadrit është parësor për mbarëvajtjen e kësaj risie historike për BKUK-në, si institucion i rëndësishëm i Kosovës.

Për shkak të mbështetjes së fuqishme të përdorimit të informacioneve bibliotekare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, aplikimi i saktë dhe profesional i komunikimit të ri në BKUK do të krijojë dhe do të kërkojë një reformë të theksuar strukturore.

Me aplikimin e teknologjisë moderne do të ketë përmirësim maksimal të shërbimeve për përdoruesit, ndërsa përshtatja dhe përcjellja e zhvillimeve përbën hallkat kryesore të suksesit komunikues në BKUK.

Futja e të dhënave në një sistem digjital, para se gjithash, kërkon krijimin e kornizës praktike të punëve profesionale dhe lidhmërinë e tyre nëpër departamente.

Si përfundim, sfidë institucionale e BKUK-së mbetet shfrytëzimi i përparësive digjitale, të cilat i ofron teknologjia e sotme informative.



Bedri Gashi është shef i Departamentit për Hulumtimin dhe Zhvillimin e Veprimtarisë Bibliotekare në BKUK.

Numri standard ndërkombëtar i serialeve

(ISSN)

Gjon BERISHA

Rritjet e mëdha të botimeve serike në botë, që janë përcjellë me ndryshime të mëdha, sollën futjen në përdorim të Numrit Standard Ndërkombëtar për identifikimin e botimeve serike (ISSN).

Në kuadër të përgatitjeve teknike dhe profesionale të botimeve serike, një vend të rëndësishëm zë edhe vendosja e numrit të ISSN-së. Për dallim nga ISBN-ja, e cila në Kosovë ka krijuar një bazë të mirë përdorimi, për ISSN-në nuk dihet fare ose dihet shumë pak. Kjo mosnjohje, ka bërë që disa revista shkencore të fakulteteve të vazhdojnë shtypjen e numrave të vjetër të ISSN-së, të cilat i ka dhënë në të kaluarën Instituti Bibliografik i Jugosllavisë.

Këto raste të freskëta, të cilat i kam vërejtur gjatë punës së përditshme, më kanë shërbyer si shkas, për të sqaruar hollësisht rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të ISSN-së, duke shpresuar se do t'u ndihmoj botuesve edhe punonjësve bibliotekarë, që këto raste të mos bëhen fenomene të përditshme.

DEFINIMI I BOTIMEVE SERIKE

Serialet janë publikime të shtypura apo të pashtypura të nxjerra në pjesë, të cilat zakonisht i kanë numrat dhe datat e botimit. Një serial mund të vazhdojë pa kufizim kohor. Serialet përfshijnë revistat, gazetatat, anualet (*sic janë raportet, librat vjetor dhe informatorët*), memoaret, transaksionet e shoqërive dhe seritë monografike.

ÇKA ËSHTË ISSN?

Numri Standard Ndërkombëtar i Serialeve (ISSN) është një kod ndërkombëtar, i cili identifikon titullin e botimeve serike dhe është unik për çdo bitim në seri (revista). Ky është një numër me tetë shifra, i përbërë nga shtatë shifra, të cilat shërbejnë si titull, plus një shifër kontrolluese, i cili në mënyrë efektive ia mundëson kompjuterit ta hetojë kur citohet një numër i pasaktë. Sistemi, i cili përdoret për llogaritjen e numrit kontrollues nganjëherë kërkon një numër kontrollues me shifër 10, ndërsa për ta parandaluar një

numër nëntë shifror, numri 10 zëvendësohet me numrin romak "X", përdryshe ISSN-ja përbëhet tërësisht nga numrat.

ISSN-ja nuk është e lidhur me pronësinë e revistës. Ajo nuk siguron të drejtat e autorit dhe nuk mbron titullin e periodikut nga përdorimi i botuesve të tjerë. Një numër i vetëm i ISSN-së identifikon një titull pavarësisht nga gjuha apo vendi, në të cilin është botuar, pa bartur barrën e përshkrimit kompleks bibliografik. Për secilën seri të periodikut, një ISSN është një "titull kryesor", korrespondues dhe është një formë e pranueshme e titullit të vendosur në kohën e vendosjes së numrit.

KUSH E PËRDORË ISSN-NË?

Ndër përdoruesit kryesorë të ISSN-së hyjnë:

- Botuesit që duan t'i identifikojnë botimet e tyre serike dhe ta përfshijnë një barkod në revistë apo gazetë për shitje nga shitësit e mëdhenj.
- Bibliotekat që përdorin ISSN-në si identifikues themelor për ta bërë dallimin ndërmjet titujve identikë dhe për t'i mundësuar procedurat e porositjes dhe kontrollimit, administrimin e grumbullimit, depozitin ligjor, huazimet në mes të bibliotekave etj.
- Bazat e të dhënave të katalogut që përdorin ISSN, si shënim të numrit kontrollues dhe pastaj mund t'i përdorin ato shënime në regjistrin e ISSN-së.
- Qendrat dokumentuese dhe bazat e të dhënave që merren me referencat bibliografike, të cilat e përdorin ISSN-in për citime më të sakta, për shërbime të abstrakteve dhe indekseve.
- Agjencitë e deponimeve që veprojnë si ndërlidhëse ndërmjet botuesve dhe përdoruesve (lexuesve), të cilët e përdorin ISSN-në për t'u siguruar se botimi i saktë është porositur.
- Akademikët që dëshirojnë t'i citojnë plotësisht të dhënat e botimeve për qëllime hulumtuese.
- Tregtarët me pakicë dhe me shumicë që përdorin barkodet e bazuara në ISSN brenda sistemeve të veta të brendshme, në mënyrë që ta vlerësojnë dhe kontrollojnë qarkullimin e revistave dhe gazetave.

DHËNIA E ISSN-SË

Qendra për ISSN në Kosovë duhet të jetë në Bibliotekën Kombëtare dhe ajo duhet të jetë përgjegjëse për caktimin e ISSN-së, vetëm për botimet serike që botohen në Kosovë.

Numri i ISSN-së u caktohet titujve të botimeve serike sipas këtij definicioni:

Botim serik është titulli që del në pjesë të njëpasnjëshme, që zakonisht ka përcaktime numerike apo kronologjike (*p.sh. Vëllimi 1., Nr.3, verë 1996*), dhe që kanë një titull të përbashkët, i cili planifikohet të vazhdohet më tej. Definicioni përfsh-



Gjon Berisha, udhëheqës i Shërbimit të Periodikut në BKUK.

inë revistat, gazetat dhe botimet e tjera serike.

ISSN-ja mund t'u caktohet edhe titujve të revistave në internet, CD-ROM-ve dhe disketave, të cilat planifikohen të dalin vazhdimisht. Botimet e ndryshme të serialeve duhet të kenë numra të ndryshëm.

ISSN-ja nuk duhet t'u caktohet botimeve që dalin vetëm një herë, ndonjë botimi të veçantë që i bashkangjitet një reviste apo gazete, si dhe adresave të internetit.

Me krijimin e sistemit të barkodeve për botimet serike, ISSN-ja, si numër i veçantë identifikues për një titull, mund të përdoret si pjesë e barkodit për ta identifikuar serialin. Në këtë rast, ISSN-ja është identifikues i titullit në barkod. Barkodet në revista paraqiten në formatin

matat e tjera bibliografike, aty ku jepen të dhënat për botuesin. Botimi i numrit nuk është i detyrueshëm, mirëpo është i këshillueshëm në mënyrë që të përfitohet plotësisht nga sistemi i ISSN-së.

SISTEMI I ISSN-SË

ISSN-ja u krijua nga Organizata Ndërkombëtare për Standarde (ISO), për shkak të nevojës për një kod të qartë identifikimi, të veçantë e të shkurtër për botimet seriale. ISO ka ardhur në përfundim se një numër tetëshifrorë është i mjaftueshëm për numërimin e të gjitha botimeve serike.

Rrjeti i ISSN-së përbëhet nga gjashtëdhjetë qendra kombëtare në botë, të cilat janë përgjegjëse për caktimin e ISSN-së për botimet seriale në shtetet e tyre. Sistemi koordinohet nga Qendra

Sa i përket kërkesave për ISSN, në lidhje me botimet serike që ekzistojnë, para se ta caktojme një numër, agjencisë i duhen edhe këto të dhëna:

- Për botimet e shtypura, një kopje e një botimi të kohëve të fundit.
- Për revistat e botuara në internet, një kopje e printuar e faqes së titullit apo ndonjë faqe, në të cilën jepen të dhëna për titullin dhe botuesin.
- Për CD-ROM-et apo revistat në diske-ta, një mostër apo një kopje e printuar e faqes së titullit, bashkë me kopjen e etiketës, dokumentimit dhe paketimit.
- Data e fillimit (rifillimit) të serialit.
- Periodiciteti i botimit.
- Informata në lidhje me titujt e tjerë (p.sh.nëse revista më herët ka pasur ndonjë titull tjetër).


NDRYSHIMI NË MES ISSN-SË DHE ISBN-SË

ISSN-ja identifikon titullin e një seriali dhe mbetet e njëjtë për atë titull botim pas botimi (për të gjithë numrat e asaj reviste), përveç në raste kur titulli pëson ndryshime, atëherë merr një numër të ri. ISBN-ja (Numri Standard Ndërkombëtar i Librit), identifikon vendin, botuesin dhe vëllimin e veçantë të botimit, si p.sh. një novelë, monografi, pra me një fjalë, ky numër i caktohet vetëm një libri.

Këto sisteme janë plotësuese dhe mund të përdoren bashkë në të njëjtin botim. Kjo ndodhë në rastet kur botimi është në mes të librit dhe periodikut. Në një libër vjetor, ISBN-ja tregon një vëllim të caktuar (përsëmbull botimi 1996 dhe ndryshon çdo vit), ndërsa ISSN-ja tregon titullin dhe mbetet e njëjtë çdo vit.

ISBN-ja nuk duhet t'u caktohet botimeve të veçanta të periodikëve. Ndryshimi kryesor ndërmjet dy sistemeve/numrave, është se ISBN-ja identifikon botuesin, ndërsa ISSN-ja nuk përbanë identifikues të botuesit. ISSN-ja thjesht mbetet e lidhur me titullin e serialit edhe në raste kur përgjegjësia për një revistë kalon tek një botues tjetër.

Si përfundim, duhet të potencohet se edhe në kuadër të Shërbimit për Rëpunimin e Periodikut është e paraparë dhënia e ISSN-së, megjithatë ky shërbim gjërë me sot nuk është kryer, sepse Kosovës nuk po i lejohet ky shërbim. Sipas qendrës së ISSN-së në Paris, të drejtën e dhënies së ISSN e kanë vetëm shtetet e pranuar ndërkombëtarisht.



EAN me një kod të shtuar dyshifrorë.

PËRSHKRIMI I ISSN-SË

Numri duhet të përshkruhet kështu: **ISSN 0000-0000**

Inicialet "ISSN" duhet të shkruhen në fillim

Pastaj një hapësirë

Pastaj katër shifrat e para

Pastaj vizëlidhëse

Dhe katër shifrat e fundit.

Kjo formë e paraqitjes nuk ka ndonjë domethënie të caktuar, mirëpo ka për qëllim ta lehtësojë leximin dhe njohjen ndërkombëtare të ISSN-së. Preferohet që ISSN të shtypet në krye të faqes, në këndin e djathtë të kopertinës së serialit. Sidoqoftë, për arsye të mosprishjes së strukturës dizajnuese, lidhjes, mbishkrimeve apo për arsye tjera, numri mund të shtypet në një pozitë tjetër të dukshme, përsëmbull, bashkë me infor-

Ndërkombëtare në Paris, e cila gjithashtu ka përgjegjësi për t'ua caktuar numrat e botimeve serike atyre shteteve që nuk e kanë qendren e ISSN-së dhe të botimeve serike, të botuara nga Organizatat Ndërkombëtare (p.sh.botimet e UNICEF-it, OSCE-së etj.).

MARRJA E ISSN-SË

Numrat e ISSN-së mund të merren para botimit përmes e-mailit, telefonit, telefaksit dhe postës, pasi të merren këto informata:

- Titulli i propozuar (duhet të jetë opcioni i fundit)
- Periodiciteti i botimit (mujore/javore/ditore etj.)
- Propozimi i datës për fillim (muaji/viti)
- Emri dhe adresa e botuesit
- Qendrës i nevojitet një kopje e botimit të parë, në mënyrë që t'i vërtetojë shënimet paraprake.

Bibliotekat dhe interneti

Etleva DOMI

Biblioteka Kombëtare, Tiranë

*Where is the agora for the global community?
The answer has to be, on the net*

Bibliotekat janë institucione që ofrojnë informacion për të gjithë shoqërinë. Në kushtet e sotme ato po angazhohen gjithnjë e më shumë në procesin e transformimeve të mëdha, të kalimit nga koleksionet tradicionale në biblioteka elektronike moderne, karakterizuar nga digjitalizimi i informacionit dhe lidhja me të gjitha burimet e ofruara nga Interneti. Në epokën e sotme bibliotekat duhet të ndërjegjësohen për të ndryshuar dhe për t'iu përshtatur sa më shumë teknologjive të reja, pasi roli i tyre është që të plotësojnë kërkesat e frekuentuesve. Sot ndryshimet janë jo vetëm të pashmangshme, por edhe të vazhdueshme. Teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit luajnë një rol determinues për revolucionarizimin e mënyrës së të menduarit, të punuarit e të jetuarit. Roli tradicional i bibliotekave është siguri i mundësive të shfrytëzimit të burimeve që ato disponojnë e ruajnë. Ndërkohë që me futjen e teknologjive të reja (botimeve elektronike, katalogëve elektronikë etj), ato duhet të sigurojnë mundësi sa më të mëdha të shfrytëzimit të burimeve të informacionit. Në këtë kuadër, duhet të kihet mirë parasysh pozicioni tepër i rëndësishëm i tyre, si në organizimin e shpërndarjen e informacionit, ashtu edhe rolin e ndërmjetësimit midis përdoruesit dhe burimeve të informacionit.

Në kushtet e shtimit të kërkesave për informacion, bibliotekat duhet të çojnë përpara si teknologjinë e informacionit, ashtu edhe atë të komunikimit. Në epokën e sotme ato duhet të bashkëpunojnë për të shkëmbyer jo vetëm përvojën, por edhe informacionin, pasi rrjeti botëror i shoqërisë së informacionit kërkon dimensione dhe angazhime të reja

bashkëpunimi. Meqenëse bibliotekat kanë hyrë në epokën e shoqërisë së informacionit, ato duhet të ridimensionojnë edhe funksionet e tyre. Ato po luajnë rol të madh në menaxhimin e këtij fluksi të madh informacioni. Nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përparuara të informacionit dhe komunikimit synohet ofrimi i shërbimeve sa më efektive për lexuesin. Bibliotekarët, si pjesëtarë në lëvizjen drejt një infrastrukture të informacionit elektronik, duhet të njohin përdoruesit me mënyrat e reja të punës dhe përdorimit të këtij informacioni. Duke qenë gjithnjë në rritje roli i bibliotekave në epokën e kibernetikës, po kuptohet gjithnjë e më shumë se Interneti është burimi më i vlefshëm që formon bazat e shërbimeve të informacionit. Prandaj bibliotekat duhet që të nxisin përdorimin e Internetit pasi ai demokritizon informacionin, duke u lejuar të gjithë përdoruesve barazi në akses.

ÇFARË OFRON SOT INTERNETI PËR BIBLIOTEKAT

Komuniteti bibliotekar është mjaft optimist për Internetin, sepse ai ofron një hap real dhe tepër konkret si në hyrjen në informacion, ashtu edhe në "bibliotekat elektronike". Interneti përbën një revolucion për bibliotekat.

Me futjen e Internetit është e mundur të shkëmbesh, në pak sekonda, nga njëra anë e planetit te tjetra, tekste prej qindra e qindra faqesh. Ai mund të konsiderohet si një tekst i madh magjik, që siguron *akses të vazhdueshëm në informacion, biblioteka, muze etj.*

Përdorimi i Internetit mundëson kalimin nga tendenca e bibliotekave për të shtuar vetëm koleksionet, në atë të shtimit të mundësive gjithnjë e më të mëdha të shfrytëzimit të tyre nga përdoruesit. Për të arritur këtë bëhen përpjekje për të bashkëpunuar në rrjetet bibliotekare brenda e përtej kufijve të vendit. Kur operacioni digjital kufizohet te digjitalizimi i teksteve mbi letër, atëherë bëhet

fjalë për biblioteka virtuale, d.m.th. bëhet fjalë për një *site* Interneti në të cilin janë grupuar tekste në formë digjitale. Natyrisht një bibliotekë e tillë nuk ka nevojë për hapësira fizike, pasi për të siguruar librin çdokush mund ta shfrytëzojë atë nga kompiuteri ku është duke punuar. Biblioteka e tilla në përgjithësi përfshijnë tekste që mund të tërhiqen falas nga Interneti (pa probleme të copyright-it). Ndonëse këto biblioteka janë një burim për hyrjen e lirë në informacion, duhet të mos harrojmë që në botën e informatikës programet evoluojnë shpejt dhe bibliotekat virtuale duhen në mënyrë të vijueshme të rifreskojnë formatet digjitale, pasi ekziston rreziku që një ditë lexuesi të mos jetë në gjendje t'i lexojë.

Interneti tashmë ofron mundësi të mëdha edhe në fushën e *zhvillimit të koleksioneve*. Kompani të fuqishme ofrojnë vazhdimisht informacione për botimet e reja, ofrojnë shërbime sipas nevojave të përdoruesve, të cilat në mënyrë të vijueshme rifreskohen. Pra Interneti ofron shërbim të shpejtë e të saktë jo vetëm për lexuesin, por edhe për vetë bibliotekat. Kjo ndikon në pasurimin e vazhdueshëm të koleksioneve të bibliotekave.

Një fenomen që ndeshet shpesh është edhe ai i *librarive virtuale*. Botuesit krijojnë site-t e tyre në internet, ku përfshijnë katalogun e tyre gjithnjë të rifreskuar dhe paraqesin librat e tyre edhe me një prezantim të shkurtër. Çdo bibliotekë mund të kërkojë e porositë libra mbështetur në kriteret e pasurimit të fondeve apo interesat e lexuesve (bëhet fjalë për bibliotekat speciale). Në ato raste kur libri është i disponueshëm, sigurohen kopje të tij.

Nëpërmjet Internetit ekziston mundësia që botuesi të vërë në dipozicion veprën apo organe të ndryshme të shtypit periodik dhe të propozojë forma *abonimi në katalogun digjital*. Vitet e fundit shumë revista e gazeta të shtypura

shqipare dhe të huaja kanë faqet e tyre në Internet.

Me anë të Internetit mund të konsultohet edhe *katalogu digjital (on-line)* i të gjithë bibliotekave, që e posedojnë atë, që ndihmon për të zgjedhur librat. Ky realitet tashmë i përhapur i mundëson kërkuesit të konsultojë katalogun e bibliotekave të ndryshme. Edhe bibliotekarit i krijon lehtësira të mëdha, pasi mund të realizohet *huazimi i librave* direkt nëpërmjet Internetit, duke iu nënshtuar të gjitha rregullave të huazimit ndërbibliotekar.

Shumica e biblioteka kanë tashmë edhe *bibliografite kombëtare* të konsultueshme në Internet, që mundësojnë grumbullimin e një informacioni të

cionit, jo vetëm që nuk janë forca kundërshtarë, por ato janë të ndërvarura nga njëra tjetra. Interneti jo vetëm që krijon lehtësira të mëdha për përdoruesin, por edhe rrit cilësinë e shërbimit të ofruar nga biblioteka.

Aktualisht bibliotekat, kudo në botë, po përballen me vështirësi ekonomike. Nga njëra anë vihet re rritja e numrit të botimeve dhe çmimeve, ndërsa nga ana tjetër kërkesat gjithnjë në rritje të lexuesve, që nuk mund të përballohen nga bibliotekat. Problem në mjaft raste mbetet edhe *copyright-i* i botimeve në Internet, gjë që e pengon shumë lirinë e informacionit, pasi jo të gjitha bibliotekat janë në gjendje të paguajnë.

Duke qenë mediatorë të hyrjeve në

duhet të përkrahin teknologjinë e përparuar, në të kundërt, ato nuk do të mund të lexojnë më në të ardhmen. Kur të duan, do të jetë tepër vonë e nuk do të dijnë as të mësojnë.

Bibliotekat aktualisht nuk kufizohen vetëm në dhënien e informacionit për çka ato kanë të mbyllura brenda mureve të tyre, por bëjnë përpjekje edhe për orientimin, udhëheqjen e lexuesit drejt shërbimeve të panjohura deri tani. Ato luajnë rolin e tyre tradicional, por në një mjedis të ri, në atë elektronik duke vazhduar të ushtrojnë një ndër funksionet më të rëndësishme, që e kanë ushtuar edhe në botën e librit të shtypur, organizimin e burimeve të dijeve në atë mënyrë që ato t'ju vijnë sa më në ndihmë përdoruesve, komunitetit, si fizikisht edhe intelektualisht. Duhet të sigurohet mbështetje për krijimin e një shoqërie të informacionit dashamirëse për përdoruesin duke kërkuar integrimin e informacionit të shtypur dhe atij elektronik. Menaxhimi i këtij informacioni pa kufi kërkon aftësi dhe kompetencë nga bibliotekarët, të cilët vetëm duke analizuar dhe shfrytëzuar burimet e informacionit mund të harmonizojnë nevojat e përdoruesve me burimet.

Shekulli që po jetojmë është shekulli i informacionit, ku informacioni është një ndër burimet më të rëndësishme si në aspektin e punës sonë, ashtu edhe në atë të jetës private. Prandaj aplikimi i teknologjive të reja krijon mundësira të mëdha për lexuesin, duke i mundësuar atij komunikimin me botën dhe duke i siguruar një informacion të shpejtë e të larmishëm.

Jorge Borges ka nënvizuar se “*Ka vetëm dy sekrete të mëdha të qytetërimit: burimi i Bibliotekës dhe i Kohës*”.

Liria dhe shoqëria demokratike kanë lindur në kulturën librore dhe pa to kjo kulturë nuk mund të mbijetojë. Për këtë arsye gjithë komuniteti i bibliotekarëve duhet të përpiqet që të realizojë integrimin e një bote të re të dijeve e komunikimit në kulturën tradicionale librore.



saktë e të shpejtë për botimet më të fundme sipas vendeve të ndryshme.

Interneti bën të mundur hyrjen në shumë burime të informacionit, të cilët mund të përdoren *për nxitjen e të lexuarit*.

Ndonëse përhapja e teknologjive dhe përdorimim i gjerë i Internetit është parë si “vdekje e librit”, “fund i leximit”, “dorëheqje nga bibliotekat”, në realitet përdorimi i tij ka çuar në rritjen e botimeve të librave e revistave, rritjen e rëndësisë së leximit dhe futjen e një sërë shërbimesh të reja në biblioteka. Kështu të lexuarit dhe teknologjia e informa-

fushën e informacionit, bibliotekat duhet të jenë midis atyre institucioneve që duhet të pësojnë transformime radikale. Duke patur parasysh rolin e madh të Internetit në epokën që po jetojmë, duhet theksuar dhe domosdoshmëria e ndryshimit të mentalitetit të drejtuesve të bibliotekave si edhe të vetë bibliotekarëve. Bibliotekarët nuk duhet të ndjehen të tradhtuar nga zhvillimet teknike, por ato duhet që të avancojnë me teknologjinë e re duke vazhduar të luajnë rol kyç edhe në erën e re të informacionit elektronik.

Si bibliotekarët ashtu edhe lexuesi

Koleksion i librave për Skënderbeun

Patricia NUGEE

Pas shumë vitesh, më në fund, jam shumë e emocionuar që ndodhem në Prishtinë me koleksionin tim të librave për Skënderbeun. Gjithmonë dëshiroja që ato të shihen nga njerëzit, historinë e të cilëve ai paraqet. Kjo tani u bë e mundur nga një sugjerim fillestar i Presidentit Dr. Rugova, si dhe ndihmës së Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, Dr. Bashotës dhe Miljane Mejzinit. Unë i falënderoj të gjithë nga zemra për entuziazmin dhe mbështetjen e tyre.

Për herë të parë dëgjova për Skënderbeun nga një klient, kur unë po punoja në një librari me libra të vjetër në Londër. Shefi im ishte ekspert i librave të vjetër, kështu që ne kishim koleksionues të interesuar në këtë fushë që vinin në dyqan. Natyrisht, që më duhej të komunikoj me klientët dhe një ditë emri i Skënderbeut erdhi në bisedën tonë. Më kujtohet si tani, se pasi klienti u largua, shkova në katin e sipërm dhe kërkova emrin e Skënderbeut në Enciklopedinë Britanike. Prej informacionit të mbledhur nga artikujt, mësova se ai ishte një luftëtar i rëndësishëm dhe një figurë e shquar e shekullit XV.

Cilësitë që Skënderbeu i kishte ishin guximi, mëshira dhe patriotizmi. Ai ishte shumë patriot, cilësi që unë e pëlqej shumë. Megjithëse si fëmijë u dërgua në Konstantinopojë nga turqit, ai kurrë nuk e harroi tokën e tij.

Natyrisht që ekzistojnë mite dhe legjenda që rrisin njerëzit e mëdhenj, po për meritat e Skënderbeut nuk ka asnjë dyshim. Për të shkruhet ende edhe pas katër qind vjet të vdekjes së tij. Është interesante të diskutohet se si Evropa do të zhvillohej nëse Skënderbeu të kishte jetuar më gjatë dhe t'i dëbonte turqit. Siç e dini ata kishin okupuar Ballkanin dhe arritën deri një Vjenë.




Edhe armiqtë e respektonin Skënderbeun. Për të cituar nga Heylyn History of the Eorld " ... pas varrosjes trupi i tij u nxor nga turqit, dhe ishte i lumtur ai njeri që mund ta merrte ashtin më të vogël nga trupi i tij."

Pas shumë leximeve për të, unë bleva librin e parë të koleksionit tim të botuar në vitin 1596 në Angli, i ofruar për shitje në njërin nga katalogët e librave të dyqanit dhe ky ishte libri im i parë nga koleksioni im i vogël për librat e Skënderbeut.

Për më tepër se 30 vjet unë kam blerë libra, jo vetëm në Londër, por edhe në Madrid, Romë dhe Glasgow. Librat gjithashtu kanë qenë të ekspozuara në Universitetin e Kembrixhit dhe në Bibliotekën e Kolegjit të Itonit. Interesi im për to më pasuron dhe ma bën jetën më domethënëse dhe tashmë bashkëkombësit e Skënderbeut kanë rastin që të vlerësojnë, se si ai është respektuar historikisht.

Ju falënderoj shumë të gjithëve për ardhjen dhe shpresoj se do të kënaqeni duke i parë librat.

(Fjala përshëndetëse e Patricia Nugee, anëtare e Shoqatës Anglo-Shqiptare në Londër, me rastin e hapjes së Ekspozitës nga koleksioni personal "Me veprat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut nga shek. XV-XVIII", mbajtur më 1 nëntor 2004, në BKUK)



Rëndësia e përdorimit të ISBN-së

Muhamed ÇITAKU

Agjencioni i ISBN-së për Kosovë ka filluar takimet e rregullta me Shtëpitë e ndryshme botueset që janë anëtare të këtij agjencioni. Për shkak të funksionimit të vonshëm është formuar një pakuptimësi e madhe rreth ISBN-së, mënyrës së përdorimit të ISBN-së, rëndësisë së saj etj. Agjencioni i ISBN-së me qëllim menjanimi të këtyre pakuptimësive dhe rregullimi të mënyrës më të mirë për qarkullimin e ISBN-së, ka ndërtuar një projekt përmes të cilit ka filluar takimet me botuesit e ndryshëm. Takimet janë zhvilluar mbi bazën e dy parimeve apo kërkesave; në atë të informimit të Shtëpive botuese lidhur me ISBN-në, rrugës për sigurimin e numrit të ISBN-së, etj. dhe përgjithësisht ligjeve në kuadër të të cilave qarkullon ISBN-ja dhe në dëshirën sa më të madhe për t'i ditur mendimet, dëshirat dhe kërkesat e botuesve përballë ISBN-së dhe pretendimit që përmes kësaj të ndërtohet një relacion më i mirë ndërkomunikimi ndërmjet këtyre dy institucioneve.

Natyrisht se secila Shtëpi botuese me të cilën kemi pasur takime ka shtruar trajtime të kërkesave të ndryshme nga të tjerat për shkak të veçantisë së problemeve me të cilat është ballafaquar ajo. Kështu, duke zhvilluar takime me çdo Shtëpi botuese janë arritur rezultatet më të mira sesa po të ishte zhvilluar një takim me të gjitha Shtëpitë botuese përnjëherë. Përfundimisht, çdo takim që është zhvilluar ka pasur bisedë të veçantë, marrëveshje të veçantë, kërkesa të vacanta dhe në përgjithësi është zhvilluar si takim i vacantë krahas takimeve të tjara.

Gjatë takimeve botuesit kanë pasur mundësi që të njoftohen me të gjitha rregullat të cilat duhet ndjekur qysh duke filluar prej mënyrës së regjistrimit në ISBN e deri te marrja e numrave të ISBN-së dhe formave se si duhet të përdoret numri i ISBN-së gjatë botimit të librit. Interesimi ka qenë i jashtëzakonshëm dhe kështu në njëfarë forme përmbushje një kërkesë dhe shprehësirë e madhe si për botuesit ashtu edhe për ISBN-në; për botuesit krijimi i një informacioni për ISBN-në ndërsa për ISBN-në menjanimi i problemeve rreth numrit të ISBN-së. Nga takimet që kemi pasur me botuesit jami bindur se problemet që ata kanë paraqitur para numrit të ISBN-së duke i botuar librat pa numër të ISBN-së ka qenë për shkak të painformimit të tyre rreth rëndësisë së numrit të ISBN-së, mënyrës së dhënies së numrit të ISBN-së etj. Libri pa numër të ISBN-së ka më pak vlerë sesa libri me numër të ISBN-së dhe gjer-sa shëpitë botuese përkujdesen për botimin e librit, atëherë botuesit e ndjenin këtë barrë. Ngecjet e librave që nuk e kanë numrin e ISBN-së janë të shumta; ai libër nuk mund të dërgohet në vende të ndryshme të botës për lexim e mësim (tipi i librave shkollor që dërgohet në vende të ndryshme ku ka pakicë shqiptare dhe ku në shkolla mësohet edhe gjuha shqipe) e as për shkëmbim me libra të



tjerë. Libri i tillë në vende perëndimore konsiderohet botim ilegal dhe për këtë nuk pranohet.

Një temë që u trajtua për shkak të problemeve të botuesve është edhe shqyrtimi i asaj se cilat materiale duhet të marrin numër të ISBN-së e cilat jo, cilat hyn në kuadër të librave e cilat jo, se a duhet të merret për çdo ribotim numri i ISBN-së apo jo, se a janë përgjegjës Shtëpitë botuese kur ato nuk kujdesen për botimin e ndonjë libri por kur t'iu jipet e drejta të dalë me emrin e Shtëpisë botuese përkatëse, etj.

Ndërsa sa i përket botuesve nuk kanë qenë të pakta rastet që kanë menduar se me numra të ISBN-së mundet një Shtëpi botuese që të manipulojë edhe ta merr numrin e një Shtëpie botuese tjetër. Kjo në njëfarë mënyre i bartte problemet dhe konfliktet e Shtëpive botuese që kanë ndërmjet veti edhe tek numri i ISBN-së, gjë e cila nuk mundet të ndodh, me ISBN-në sepse çdo Shtëpi botuese e ka kodin e vet të ISBN-së dhe vetëm ajo mundet ta shfrytëzojë atë e jo dikush tjetër.

Një përparësi dhe sukses i madh që është arritur gjatë këtyre takimeve është edhe sjellja e listave të botimeve përmes së cilave vërtetohet jo vetëm sasia e librave që i mungojnë BKUK-së por edhe titujt e atyre librave të cilët i mungojnë. Këto lista përveç tjerash kanë qenë të rëndësishme edhe për faktin se me to vërtetohet se sa botime të një Shtëpie botuese kanë dalë pa numër të ISBN-së, cilët janë ata tituj, me çfarë karakteri janë ato libra, etj. Në bazë të këtyre të dhënave shihet se numri i ISBN-së gjatë vitit 2001, 2002 ka qenë shumë pak i përdorur në krahasim me botimet të cilat kanë dalë në Kosovë gjatë asaj kohe. Rritja e përdorimit të tij është bërë në vitin 2003 dhe 2004 çka dëshmon se numri i ISBN-së është duke shkuar dhe duke u stabilizuar. Në bazë të listës së dorëzuar vrehet gjithashtu se shumica e botimeve pa numër të ISBN-së ose kanë qenë ribotime të cilat janë botuar me të njëjtin numër të ISBN-së edhe pse ka pasur ndryshime në libër (në këtë rast ai numër i ISBN-së është i pavlerë) ose ka qenë literaturë që nuk kanë menduar se i duhet numri i ISBN-së.

Mundësia e përdorimit të MARC21 në BKUK

Besim J. KOKOLLARI

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës tashmë është duke u përgatitur për të hyrë në fazën e rëndësishme të automatizimit të veprimitarisë së saj bibliotekare. Në fushën e informacionit, kjo bibliotekë pritet që brenda pak vitesh të prosperojë fuqishëm dhe të ecë në hap të barabartë me bibliotekat e zhvilluara botërore, dhe krahas me të, edhe rrjeti i bibliotekave të Kosovës.

Nënkuptohe se Biblioteka Kombëtare do t'u ofrojë informacione vendësve dhe ndërkombëtarëve, për thesaret e vendosura në depo. Mosshfrytëzimi i kësaj pasurie të paçmueshme, është pasojë e mungesës së informacionit modern, të cilin duhet ta posedojë përdoruesi i shekullit të XXI, i cili as që ka ndërmend t'i kthehet praktikave të vjetëruara, por dita ditës është i prirur të braktisë çfardo biblioteke, nëse ajo nuk ia siguron të gjitha parakushtet.

Për të shpërndarë sa më shumë informacione, të cilat Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, do t'i ofrojë për përdoruesit vendës, por edhe për përdoruesit e bibliotekave botërore, më poshtë janë paraqitur aspekte të formatit MARC 21, i cili mendohet të jetë formati më i përdorur në botë për kodimin e informacioneve bibliografike të njësive bibliotekare.

Në pika të shkurtëra është paraqitur MARC-21, përparësitë e tij përdoruese në krahasim me formatet e tjera dhe disa prej arsyeve se përse Biblioteka Kombëtare dhe Univeristare e Kosovës duhet ta zgjedhë këtë skemë kodimi.

Fjala MARC në plotëni është Machine-Readable Cataloging = Katalogu i Lexueshëm nga Makina. Ky format u krijua nga Biblioteka e Kongresit në SHBA kah fundi i viteve të gjashtëdhjeta, kohë kjo kur u paraqitën edhe kompjuterët e parë, ndërsa, numri 21 personifikon shekullin e njëzetentë, i cili iu shtua

MARC (Universal Machine-Readable Cataloging), NORMARC, IberMARC, SANMARC (Versioni i Afrikës së Jugut), etj, që shpiejnë drejt zbatimit të rregullave të ndryshme për kodimin e të dhënave bibliografike të njësive bibliotekare, dhe në një shpërputhje të të dhënave bibliografike, duke vështirësuar sadopak shkëm-



Zonat përshkruese të informacionit në formatin MARC - 21

inicialeve MARC nga Biblioteka e Kongresit dhe Biblioteka Kombëtare e Kanadasë me rastin e harmonizimit të formatit USMARC (United States MARC) dhe CAN/MARC (Canadian MARC). Siç shihet nga këto dy versione dhe nga disa të tjera më poshtë, shumica e vendeve kanë bërë modifikime të formatit MARC, për t'ia përshatur nevojave kombëtare e, për rrjedhojë, kemi variante të ndryshme të këtij formati: UKMARC (Versioni britanik i formatit MARC), UNI-

bimin e informacioneve ndërmjet sistemeve të ndryshme bibliotekare. Pikërisht për këtë qëllim, është bërë edhe harmonizimi i versionit USMARC dhe CAN/MARC në MARC 21, i cili përdoret pothuajse në çdo vend të botës, përfshirë këtu edhe Bibliotekën e Kongresit Amerikan, Bibliotekën Kombëtare të Kanadasë, së fundi edhe Bibliotekën e Britanisë së Madhe, pastaj në vende të ndryshme, si në Zelandë të Re, Rusi, Afrikë të Jugut, Amerikë Jugore,

Meksikë dhe Brazil, në Azi: Tajlandë, Malajzi, Kinë; në Lindjen e Mesme: Egjipt, Arabi Saudite dhe Kuvajt, si dhe në shumë e shumë vende të tjera.

Sipas Crawford (1989) (siç citohet në Fritz 2003), shënime në formatin MARC janë: "Shënime të krijuara në kompjuter, të rënditura në bazë të standardeve të përcaktuara dhe të përpiluara për identifikimin, ruajtje dhe paraqitjen e tyre në katalog". Pra, ato janë informacione të cilat mund të interpretohen nga kompjuteri, përmes të cilit mundësohet edhe shkëmbimi i tyre ndërmjet bibliotekave të ndryshme.

Këto rregulla përshkruhen hollësisht në librin Rregullat anglo-amerikane të katalogimit, të njohura me inicialet AACR2.

Përparësia e përdorimit të formatit MARC 21 në përshkrimin bibliografik është harmonizimi i të dhënave bibliografike në të gjitha bibliotekat që përdorin këtë format. Ky harmonizim është i domosdoshëm pasi secili produkt i veçantë i një vendi, qoftë ai intelektual apo i një natyre tjetër, është bërë edhe produkt botëror në sate të teknologjisë së re dhe mjeteve të komunikimit. Për më tepër edhe rëndësia e atij produkti, tash matet në bazë të kërkesës ndërkombëtare e jo vetëm në bazë të asaj kombëtare.

Prandaj, produktet e informacioneve që krijojnë bibliotekat dhe institucionet e tipeve të tilla, si të dhëna bibliografike të njësive bibliotekare, mund të shkëmbehen ndërmjet bibliotekave me një efikasitet të madh po që se bëhet një harmonizim i formatëve të sotme që janë në përdorim.

Biblioteka e Britanisë së Madhe ka hequr nga praktika krijimin e të dhënave bibliografike në formatin UKMARC dhe ka filluar me formatin MARC 21. Në një artikull, në të cilin flitet për standardizimin e formateve, thuhet: "Ju mund ta krijoni edhe metodën tuaj të organizimit të informacioneve bibliografike, por ju do ta izolonit bibliotekën tuaj, do ta kufi-

zonit pozitën e saj, si dhe do t'i krijoniit shumë punë vetes po që se nuk e shfrytëzoni një format standard".

Në faqen e saj të Internetit, Biblioteka e Britanisë së Madhe, i paraqet arsyet kryesore për futjen në përdorim të formatit MARC 21, të cilat janë paraqitur në tekstin e mëposhtëm, që mund ta ndihmojnë edhe procesin e ardhshëm bibliotekar, për ta bërë zgjedhjen e duhur në mesin e disa formateve. Ato janë:

Mundësia për të nxjerrë të dhëna bibliografike nga një numër i madh bibliotekash, posaçërisht, nga ato të Amerikës Veriore dhe nga shërbimet e tjera bibliografike;

MARC 21 paraqet një mënyrë më efikase në rast se në të ardhmen vendoset për shfrytëzimin e në një sistemi tjetër standard të metadatave, ndonjë format jo-MARC, të cilët janë krijuar në Amerikën Veriore;

MARC 21 i përket një familjeje shumë më të zhvilluar të formateve standarde, që mbulon në mënyrë superiore materialet jo-libra, dhe mbështetet në formatet e veçanta për të dhëna bibliografike, si dhe në listat e autorizuara të emrave dhe lëndëve;

MARC 21 mirëmbahet vazhdimisht dhe mbështetet me dokumentacione më shumë sesa formati UKMARC.

Korrespondencat e Leonard Billit nga Biblioteka Kombëtare e Kanadasë, sjellin mundësi shtesë për një bibliotekë nëse ajo vendosë ta përdorë këtë format. Ato janë:

Formati MARC 21 mund të përdoret edhe në bazë të rregullave të tjera të katalogimit: ISBD, AACR2, Dublin Core, etj.;

Shpërndarja e gjerë botërore e të dhënave bibliografike të krijuara në formatin MARC 21 paraqet një faktor të rëndësishëm, i cili gjithsesi duhet të merret parasysh dhe se nuk ekziston ndonjë bazë me të dhëna bibliografike, të tilla si OCLC-ja, që të mos ketë informacione bibliografike në formatin MARC 21;

Formati MARC 21 është nën përkujdesin e vazhdueshëm të Bibliotekës së Kongresit dhe Bibliotekës Kombëtare të Kanadasë, të cilat e bëjnë për çdo vit korrigjimin e rregullave të ndryshme për t'iu përshatur kërkesave të bashkësisë bibliotekare;

Shumica e katalogëve të bibliotekave mund të kërkohen përmes Internetit, si dhe përmes protokollit Z39.50. Kjo mundëson që biblioteka t'i kopjojë të dhënat e katalogut me një shpejtësi dhe lehtësi të madhe. Mospërzgjedhja e formatit MARC 21 do ta detyrojë cilëndo bibliotekë që të bëjë konvertimin e të dhënave;

Të gjitha formatet MARC bazohen në standardin ndërkombëtar ISO 2709 dhe në homologen e saj amerikane, ANSI/NISO Z39.2.

Këto që u thanë më lart, mund të shërbejnë edhe si pika mbështetëse për Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, se përse duhet që ajo ta përzgjedhë pikërisht formatin MARC 21, për kodimin e të dhënave bibliografike, të cilat pritet t'i krijojë në një të ardhme të afërt.



Besim J. Kokollari është punonjës i Bibliotekës së Këndit Amerikan

Udhëzime për blerjen e resurseve elektronike

Frederic FRIEND

(vijon nga numri i kaluar)

KUR TË KETË FILLUAR NEGOCIMI...

Qëndroni i qetë dhe i patundur!

Ka një rast për të shprehur fuqimisht pikëpamjet, sidomos në pika të caktuara gjatë negociimit (për shembull, nëse marrëveshja duket aq e keqe saqë ju nuk mund ta pranoni atë). Mirëpo, humbja e tempertamentit do të mund të ishte kundërproduktive duke ia bartur kështu përparësinë emocionale palës tjetër. Është poaq e rëndësishme të qëndroni i qetë në mënyrë që të mund të vëreni dobësitë tek pala tjetër. Ata që përfaqësojnë anën tjetër do të shikojnë për dobësi në rastin tuaj dhe nuk është e këshillueshme që t'u mundësoni të shihen çfarëdo përfitimi të syrit tek ju. Mundohuni t' vini në pozitë të prapme duke kërkuar nga ata të arsyetojnë pozicionin e tyre pa pasur nevojë që ju të shpejgoni pozicionin tuaj, në mënyrë që të qëndroni në kontroll të negociatave.

MBANI AGJENDËN NËN KONTROLL

Është me rëndësi për ju – më parë se për botuesin – të paraqitni agjendën e çështjeve që duhet zgjidhur. Përgatitja paraprake e një liste të pikave që dëshironi t'i diskutoni dhe të treguarit e kësaj liste botuesit qoftë pak para takimit apo me rastin e fillimit të takimit ju vë në ulësen e drejtuesit. Përdorni fjalë të thjeshta e të hskurtra, fjali të thjeshta dhe të shkurtra në paraqitjen e mesazheve tuaja kyçe. Që të dy palët në negociim

duhet të kuptojnë njëri-tjetrin qartë, nëse duam që të mos kemi një rezultat konfuz. Disa nga çështjet kyçe që do të dëshironit t'i diskutoniit janë:

- një listë e përmbajtjes që duhet përfshirë në blerje,
- çfarëdo ndryshimi që mund t'i bëhet asaj liste përmbajtjeje gjatë periudhes së kontratës,
- definimi i “shfrytëzuesve të licensuar”, përfshirë edhe shfrytëzuesit “kalimtarë”,
- përcaktimi i institucionit apo i “sajtit” – p.sh. për institucionet me ëshumë sajte,
- qasje “jashtë sajtit” për shfrytëzues të licensuar,
- dërgimi i kopjeve të pjesëve të përmbajtjes – p.sh. artikuj gazetaresk – bibliotekave të tjera,
- qasje permanente në përmbajtjet e licensuara.

Të gjitha këto çështje paraqesin kërkesat bazë nga pikëpamja bibliotekare dhe, pos gjatësisë së kontratës, kjo nuk duhet të ketë ndikim në çmimin e paguar. Për shembull, botuesi mund të presë nga biblioteka që të paguajë më shumë për qasje permanente në përmbajtje, por bibliotekës duhet dhënë një kopje e përmbajtjes në CD, si pjesë të çmimit bazë.

DUHET TË DINI SE KUR TË BËNI TË KOMPROMIS.

Nëse duam që negociimi të jetë i suksesshëm, është pothuajse e pashmangshme se do të ketë kompromis. Negociimi fitore-fitore është i mirë: kur të gjitha palët në një marrëveshje janë të kënaqura, ata do të duan që kjo të ketë sukses. Secila palë mund të

largohet nga negociatat nëse mendon se nuk do të marrë asgjë nga marrëveshja, prandaj duhet të jeni të gatshëm që të bëni ca koncesione nëse duani që negociimi të ketë sukses. Arti qëndron në të diturit se në çfarë duhet lëshuar pe dhe kur. Mos u mundoni t'ia bëni të ditur palës tjetër se ju jeni të gatshëm të lëshoni pe deri në çastin e fundit dhe bëni që ai të duket si një koncesion i MADH. Lëshuarja pe nga diçka që botuesi ka kërkuar u jep avantazhin moral kur të kërkonit për ndonjë koncesion nga botuesi, që është me rëndësi për ju. Nëse ata kërkojnë të bëni një koncesion specifik – p.sh. një marrëveshje më aftagjatë – ju do të dini se ky koncesion është i rëndësishëm për ta dhe nëse kjo nuk është e rëndësishme për ju, ju mund të lëshoni pe zemërgjerësisht, duke kërkuar për një koncesion tuajin që është me rëndësi për ju. Koncesioni që ju mund të kërkonit nuk duhet përshkruar si “koncesion”, por të përshkruhet në mënyrë modeste, si diçka që është aq e qartë dhe e pakundërshtueshme saqë asnjë person me mend në kokë nuk do të mund të mos pajtohej! Nëse botuesi refuzon të pajtohet me këtë, atëherë ju duhet të vendosni nëse doni të vazhdoni te merreni me atë pikë, apo të hiqni dorë, në mënyrë që t'i ktheheni prapë gjatë negociimit të ardhshëm. Deklarimi se ju jeni të gatshëm të heqni dorë nga ajo pikë nuk është punë me mend, pasi që kjo u jep atyre mesazhin se kjo pikë nuk është e rëndësishme për ju. Shumica e takimeve të negociimit mbulojnë një numër të madh çështjesh, prandaj është me rëndësi të mbani shënime mbi koncesionet që janë bërë e janë marrë gjatë takimeve të negociimit.

DUHET TË DINI KUR TË THUANI “JO” E TË LARGOHENI.

Ky ka qenë veprimi më i rëndë për bibliotekarët në negociatat e tyre me botuesit. Dëshira e një bibliotekari për të futur në dorë një përmbajtje për të cilën kanë nevojë shfrytëzuesit i ka shtyrë ata të pranojnë kushte që do të ishin të papranueshme për negociatorë nga kompani komerciale. Ndërprerja e negociatave nuk është një veprim që merret me lehtësi, por ai duhet ndërmarrë nëse marrëveshja tregohet se nuk paraqet përparësi për bibliotekën. Kjo është sidomos me rëndësi për negociatat konzorciale, kur një marrëveshje duhet të tregojë dobitë e mëdha ndaj një marrëveshjeje për një bibliotekë të vetme. Dobitë mund të jenë financiare apo në raport me përmbajtjet. Rëndom shitësi rrezikon më shumë sesa bibliotekarët nëse dështon negociimi, prandaj negociuesit konzorcistë mund të lejojnë që të jenë negociues të ashpër. Nëse negociatat ndërpriten, pala që lë negociatat duhet t'i qartësojë çështjet mbi të cilat të dy palët nuk janë pajtuar. Kjo bën të mundur rifillimin e negociatave, nëse ka ndonjë ndryshim në qëndrime lidhur me ato çështje të veçanta, pa u kthyer në agjendën e plotë, pjesa më e madhe e së cilës ka qenë e pakontestuar. Duke kaluar nëpër tërë agjendën edhe njëherë paraqet rrezik edhe për humbjen e koncesioneve për negociatorët e bibliotekës të bëra nga botuesi me pajtim paraprak.

PASI TË KETË MBARUAR NEGOCIMI.....

Dërgoni një letër apo e-mail sa më shpejtë me rezymimin e të kuptuarit tuaj të marrëveshjes së arritur.

Kjo është një pikë në të cilën bibliotekarët shpesh dështojnë. Ne ia lëmë shitësit që të na shkruajë për të na e thënë se për çfarë është marrëveshje dhe nuk është për t'u befashuar kur shohim se versioni i shitësit e asaj



për të cilën është arritur pajtim – apo edhe theksi i vënë mbi disa pika të veçanta të marrëveshjes – ndryshon nga shënimet që kemi marrë ne gjatë negociatave. Kjo e vë shitësin në ulësen e prapme nëse bibliotekari sjell i pari shënimet lidhur me atë për të cilën janë pajtuar. Po ashtu edhe në diskutimet pasuese me agjencitë financuese, siç janë departamentet qeveritare, është mirë të dërgohen e-maile duke përkufizuar atë për të cilën ju mendoni se është arritur pajtim, pasi që politikanët dhe shërbyesit civilë harrojnë shumë kur sulmohen nga presione të shumta pas takimeve me ta. Nëse pala tjetër konteston diçka të cilën ju e keni shkruar si diçka për të cilën është arritur pajtimi, ajo pikë mund të diskutohet pavarësisht nga pikat e tjera në marrëveshje, ndonëse një pikë vërtetë kyçe që mohohet më vonë mund të bëjë që ju të mos vazhdoni me etapën kontraktuale. Një letër apo e-mail ku shprehet marrëveshja për të cilën ju mendoni se e keni, mund të kursejë kohë dhe mundim në rastin kur marrëveshja shndërrohet në kontratë me obligim ligjor. Zgjidhni të gjitha problemet para se të involvohen avokatët.

NËNSHKRUANI NJË KONTRATË LEGALE SA MË SHPEJTË QË TË JETË E MUNDUR.

Porsa të keni arritur një marrëveshje të kënaqshme, duhet të jeni të sigurtë që ajo të zbatohet dhe se shitësi nuk do të thotë se rrethana të reja kanë lindur që do të thotë se kushtet e marrëveshjes suaj duhet të ndryshojnë. Porsa të jetë bërë kontratë – dmth. kontratë ligjësisht obligative dhe jo letër e pajtueshmërisë – shitësi do ta respektojë atë, ngaqë një kontratë e mirë do të përmbajë edhe dispozita ndëshkuese. Natyrisht, ky është një proces i ndërsjellë dhe bibliotekari nuk do të jetë në gjendje të shkojë tek shitësi dhe t'i thotë se rrethanat e bibliotekës kanë ndryshuar. Kontrata duhet lexuar me kujdes për të qenë të sigurtë se ajo reflekton pikat e miratuar në negociatë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme nëse marrëveshja juaj me botuesin përmbanë dispozita që janë të pazakonshme, pasi që botuesi, për arsye të ndryshme, mund t'u dërgojë kontratë standarde, të ëprdorur për çdo konzorcium tjetër apo bibliotekë individuale. Sigurohuni që çfarëdo pike e veçantë për të cilën jeni pajtuar të jetë e futur në kontratë.

SI PO E PËRGATISNI BIBLIOTEKËN TUAJ PËR TË ARDHMEN?

Bibliotekat duhet t'i plotësojnë kërkesat e komunitetit



Përgjigjet: Sylejman Pireva, drejtor i bibliotekës ndërkomunale "Hivzi Sulejmani", Prishtinë

Gjendja jo e mirë e bibliotekës ndërkomunale "Hivzi Sulejmani", e trashëguar nga e kaluara, veçmas pas luftës, me probleme të infrastrukturës në fushën ndërtimore dhe në atë ligjore, me fonde të koleksioneve me shumicë të vjetruara, të pamjaftueshme dhe pak të përtërira, në njërin anë, si dhe shtimi i popullatës në qytet gjatë viteve të fundit, e me këtë edhe rritja e kërkesave të përdoruesve, në anën tjetër, janë indikatorë që trokasin në ndërgjegje dhe të thërrasin për ta ndër-

ruar këtë gjendje, për të bërë ndryshime dhe kthesa sa më të shpejta.

Biblioteka tashmë ka një staf të përgatitur për t'i shpënë përpara proceset e lëmit të bibliotekarisë, por tani ky staf ka kuptuar se këto procese, përkundër angazhimit me përkushtim, nuk mund t'i shpiejë dhe aq larg, sepse pengesë e parë del infrastruktura e papërshtatshme dhe e pamjaftueshme e ndërtesës së bibliotekës, e cila nuk mundëson për të bërë ndonjë përparim të dukshëm, sepse ajo nuk i plotëson me asnjë element standardet e një biblioteke moderne. Dhe për këtë arsye kjo është e penguar për t'i plotësuar në mënyrë të kënaqshme nevojat e komunitetit që i përket, kurse ky komunitet është hiç më i vogël se 0.5 milion banorë, i përbërë nga shumë shtresa të shoqërisë, me disa gjuhë e me disa konfesionë.

Sipas standardeve të IFLA-s për 1000 banorë kërkohet hapësirë 56 m², që do të thotë se për 100 mijë banorë lypset hapësirë me sipërfaqe 5600 m². Dhe kur kjo të llogaritet për 500 mijë banorë, sa mund të ketë Prishtina sot, del se objekti i kësaj biblioteke duhet të ketë një hapësirë së paku prej 20 mijë m². Dhe vetëm atëherë do të kishte hapësirë për miliona kopje të materialit të shtypur,

libra, gazeta, revista, si dhe material audiovizual etj., për funksionimin normal të të gjithë sektorëve, për salla të mjaftueshme për përdoruesit e rritur, fëmijë dhe hulumtues, për përdoruesit me aftësi të kufizuara, për Internet, për aktivitete bibliotekare, kulturore, sociale etj. Sot kjo bibliotekë ka vetëm vetëm 477 m²!

Biblioteka në rend të parë vlen për përdoruesit dhe vetë ata i jepin kuptim asaj, përndryshe nuk do të duhej të ekzistonte fare. Prandaj, biblioteka u detyrohet në rend të parë atyre dhe është përgjegjëse për ta. Unë si udhëheqës, së bashku me stafin tim, jemi të ndërgjegjshëm dhe e kemi kuptuar se sa larg është kjo Bibliotekë për të plotësuar kërkesat e shumta të komunitetit të kryeqytetit. Kuadri i bibliotekave tona në përgjithësi është deficitar. Për këtë arsye jemi të preokupuar për formimin e kuadrit të kësaj biblioteke, të arsimuar dhe të edukuar si duhet, sepse kontakti dhe komunikimi me përdoruesit e kërkon këtë, mandej specializimin e punonjësve për punë të veçanta në sektorët e ndryshëm etj.

Preokupim i përhershëm i yni është pasurimi i koleksioneve me literaturë të larmishme dhe të pasur. Aktualisht një ekip prej 12 vetash është duke punuar në revizionin e koleksioneve, proces ky që planifikohet të kryhet në të gjithë sektorët dhe degët e bibliotekës, me të vetmin qëllim, për të parë se çfarë mund të bëjmë në të ardhmen për të plotësuar kërkesat e të gjithë përdoruesve, të të gjitha kategorive, pa pritur se si dhe kur do të zgjidhet problemi i hapësirës, duke e shfrytëzuar në maksimum këtë që është.

Angazhimi që format e shumta të punës të automatizohen në saje të teknologjisë më të re, të informacionit etj., do të jetë një objektivi tjetër i intresimit dhe shpresës sonë. Këtë optimizëm e mbështesim në mundësinë e shfrytëzimit të programit kompjuterik

Aleph 500, për bibliotekari, që presim të na ofrojë BKUK para këtij fundviti, do të krijonte shansa reale për futjen në një rrjet të përbashkët të gjitha bibliotekat në Kosovë. Sigurisht që pas arritjes së këtij animi, pritet rritja e dukshme e efikasitetit në shërbime me përdoruesit, në cilësi dhe në sasi.

Karta e të drejtave të bibliotekave

Asociacioni i Bibliotekave Amerikane konfirmon se të gjitha bibliotekat janë forume të informacionit dhe ideve, dhe se shërbimet e tyre duhet të udhëhiqen prej parimeve themelore vijuese.

- I. Librat dhe burimet e tjera bibliotekare duhet të sigurohen për interesin, informacion dhe ndriçimin e të gjithë bashkësive të cilave ju shërben biblioteka. Materialet nuk duhet të përjashtohen përshkak të origjinës, historisë, apo pikëpamjeve të atyre që kanë kontribuar për krijimin e tyre.
- II. Bibliotekat duhet të ofrojnë materiale dhe informacione të

cilat paraqesin pikëpamje të ndryshme sa i përket çështjeve aktuale, e po ashtu edhe atyre historike. Materialet nuk duhet të ndalohen ose të largohen për shkak të doktrinave apo pikëpamjeve partizane.

- III. Bibliotekat duhet ta sfidojnë censurën në përmbushjen e përgjegjësisë së tyre sa i përket ofrimit të informacionit dhe ndriçimit të mendjes.
- IV. Bibliotekat duhet bashkëpunojnë me të gjithë personat dhe grupet që balafaqohen me kufizimin e lirisë së shprehjes dhe të qasjes së lirë në ide.

V. E drejta e një personi për ta shfrytëzuar një bibliotekë nuk duhet të mohohet ose të kufizohet për shkak të origjinës, moshës, historisë, apo pikëpamjeve të tij.

VI. Bibliotekat, të cilat i vënë në dispozicion hapësira ekspozuese apo dhoma takimesh publikut që i shërbejnë, duhet t'i ofrojnë këto hapësira në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh besimin, përkatësinë e individëve apo të grupeve të cilat kërkojnë ta shfrytëzojnë atë hapësirë.

E adoptuar më 18 qershor të vitit 1948, e korrigjuar më 2 shkurt 1961 dhe më 23 janar 1980, dhe e konfirnuar sërish më 23 janar 1996, nga Këshilli i ALA-s

<http://www.ala.org/ala/oif/statementspols/statementsif/librarybill-rights.htm>



Misioni i LIBER-it

LIBER përfaqëson dhe promovon interesat e bibliotekave hulumtuese në Evropë. Qëllimi i përgjithshëm i LIBER-it është të ndihmojë bibliotekat hulumtuese në Evropë që të shndërrohen në një rrjet funksional jashtë kufijve kombëtarë në mënyrë që të sigurojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore evropiane dhe të ofrojë shërbime më efikase informative në Evropë. (Nga Statuti i LIBER-it, miratuar në Göttingen, në korrik 1994).



ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË BIBLIOTEKAT EVROPIANE HULUMTUESE

- Zhvillimi i bibliotekës 'hibride' apo 'elektronike' me bartje të fokusimit midis koleksioneve fizike dhe atyre digjitale.
- Disponueshmëria gjithnjë më e madhe e informacionit hulumtues në formë elektronike me mundësi qasjeje të rrjeteve globale nga kudo dhe në çdo kohë.
- Ndryshimet e rëndësishme në zingjirin informativ pasi që komunikimi i drejtpërdrejtë midis autorëve dhe lexuesve është i

mundshëm në shkallë globale.

- Bashkëpunim më i madh midis bibliotekave përmes rrjeteve dhe konzorciumeve rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare me botues.
- Ndryshimet në konceptin e zhvillimit të koleksioneve në linjë me evoluimin gradual të koleksioneve virtuale.
- Në fushën e informacionit elektronik, marrëveshjet midis bibliotekave dhe botuesve nuk do të qeverisen më kryesisht nga ligje të drejtave autoriale, por nga ligjet kontraktuale, që qeverisin natyrën e licensave.
- Zhvillimi i e-serviseve dhe e-menaxhimeve në biblioteka.

TRENDET POLITIKE DHE EKONOMIKE

Qeveritë

- Qeveritë po dedikojnë fonde proporcionalisht më të vogla në fushën e përgjithshme të kulturës dhe arsimit, andaj edhe për biblioteka. Në të njëjtën kohë, funksionimi i bibliotekave është duke u bërë gjithnjë më i shtrenjtë, pjesërisht për shkak të nevojës për shërbime të dyfishta: të shtypura dhe elektronike.
- Qeveritë janë më shumë të prirura t'u ofrojnë bibliotekave autonome, universitare dhe nacionale, buxhete "njëlinjëshe" apo "paushalle", duke i lënë të vendosin vetë për prioritetet.
- Qeveritë po tregojnë më shumë interesim në arsimimin e 'mjeshtrove' dhe 'profesionave praktike' me theks të shtuar në racionalen ekonomike.

Universitetet

- Universitetet janë më të interesuara në atë që bëjnë bibliotekat dhe më shumë të prirura për

përqëndrim të objekteve fizike bibliotekare, për të kursyer sa më shumë; disa universitete mund të vëjnë në dyshim nevojën për të pasur një bibliotekë të madhe qendrore.

- Universitetet do të jenë të prirura t'u ofrojnë bibliotekave të tyre ose buxhete 'njëlinjëshe' apo edhe të ndajnë një për pjesë të shpenzimeve bibliotekare fakulteteve/shkollave dhe katedrave; cilado mënyrë do të ketë më pak kontroll qendror nga universiteti për shpenzimet bibliotekare.
- Universitetet po i bëjnë botimet e tyre hulumtuese, që kanë qasje në ueb dhe po hulumtojnë për alternativa të botimeve komerciale.
- Qeveritë dhe universitetet po bëhen gjithnjë më të interesuara për 'e-shkencë' (hulumtimet shkencore që bëhen nga shfrytëzimi i masave të mëdha të të dhënave elektronike) dhe 'e-studimit' (materialet teknike dhe mbështetja studimore që jepet përmes rrjeteve); kurse bibliotekat janë në ballë të e-shërbimeve.

SUPOZIMET LIDHUR ME BIBLIOTEKAT HULUMTUESE NË EVROPË NË TË ARDHMEN

- Ndikimi më i fuqishëm në bibliotekat hulumtuese do të jetë ekonomia globale e rrjetëzuar.
- Elementi parësor në zingjirin informativ do të jetë rrjeti.
- Një pjesë e madhe e asaj që bibliotekat deponojnë tradicionalisht në raftet e tyre do të digjitalizohet dhe do të kenë qasje përmes rrjeteve.
- Arkivimi dhe ruajtja e material digjital do të jetë një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat do të ballafaqohen bibliotekat.
- Depozitimi legal i materialit digjital do të bëhet normë brenda pesë vjetësh.
- Proceset tradicionale të shtimit të vlerës së informacionit në bibliote-

ka (dmth. katalogizimi) do të vazhdojë të kalojë nga 'zyra e prapme' në 'zyrën e përparme', ku stafi i bibliotekës takohet me lexues; ndonëse detyrat e reja të 'zyreve të prapme' (metodat dhe standardet) do të bëhen të rëndësishme.

- Rrjetet do të bëjnë të mundshëm një bashkëpunim dhe këmbim më të madh; vendimi kritik do të përcaktohet varësisht se në çfarë niveli (rajonar, kombëtar apo ndërkombëtar) do të ndodhë një këmbim i tillë.
- Do të ndihet nevoja për standardizim, për të zhvilluar këmbimin informativ elektronik dhe zbulimin informativ.
- Të drejtat e pasurisë intelektuale do të vazhdojnë të kërkojnë diskutim të gjerë: autorët, universitetet, bibliotekat dhe botuesit do të kërkojnë të bëjnë vetë depozitime, posaçërisht sa u përket të drejtave të autorit.
- Për të plotësuar sa më mirë nevojat e shfrytëzuesve të bibliotekave, materiali i rrjetëzuar duhet të mbetet, porsì materialet në raftet, nën kontrollin e bibliotekave pjesëmarrëse.
- Çështja e të drejtave të pasurisë intelektuale do të ngre çështjen e pagesës për shfrytëzimin e materialit: kush paguan, në emër të kujt dhe në cilën pikë?
- Operuesit komercialë do të sjellin konkurrencën për bibliotekat, sidomos për dorëzime të materialeve.


ÇËSHTJE TË BIBLIOTEKAVE HULUMTUESE NË EVROPË NË TË ARDHMEN E AFËRT

- Ballafaqimi me zhvillime të diferencuara në pjesë të ndryshme të Evropës dhe nevoja për të siguruar zhvillim konsistent në libraritë e tërë Evropës.
- Zhvillimi dhe implementimi i standardeve për të siguruar këmbim informacioni elektronik dhe

zbulimet informative.

- Identifikimi dhe implementimi i zgjidhjeve të shëndosha për arkivim dhe ruajtje digjitale.
- Ballafaqimi me konkurrencën e operuesve komercialë, sidomos sa i përket dorëzimit të materialeve.
- Forcimi dhe promovimi i bashkëpunimit në mesin e institucioneve trashëgimore (arkivave, muzejeve dhe galerive).
- Zhvillimi dhe forcimi i marrëdhënieve me institucionet përkatëse në përmasa ndërkombëtare.

Përgatiti: V. M.



Egjipt

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, gjegjësisht institucioneve, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës zyrtarisht ka autorizuar Prof. Dr. Beqir Ismailin që të shërbejë si Person Ndërmjetësues për qëllime të bashkëpunimit të përgjithshëm me Egjiptin dhe Arabinë.

Prof. Beqir Ismaili, i cili u caktua si Person Ndërmjetësues ndërmjet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekave të Përgjithshme të Egjiptit dhe Bibliotekave të Botës Arabe do të angazhohet për të gjitha kontaktet, që kanë të bëjnë me bibliotekarinë, siç janë: huazimi ndërbibliotekar, donacione librash, vizita etj, ndërmjet bibliotekave të lartpërmenduar.



Zvicër

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të BKUK-së me vendet tjera, ditë më parë në Zug të Zvicrës drejtori i BKUK-së Dr. Sali Bashota nënshkroi donacionin –dhuratë nga asociacioni zviceran Trans-fair.org.

Ky donacion e cila arrin në vlerë rreth 150.000 Franga zvicerane, përmban kryesisht inventarë për 50 -70 zyre. Përfaqësuesi i këtij asociacioni, me rastin e dhënies zyrtare të këtij donacioni vlerësoi se ky është vetëm një fillim i ndihmës që po i bëhet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ndërsa në të ardhmen ky institucion do të gëzojë edhe donacione tjera të cilat do të ndikojnë fuqishëm në mbarëvajtjen e punëve dhe në zhvillim të hovshëm të Bibliotekës.

Poloni

Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, ditë më parë u përfaqësua në nivel ndërkombëtar në Asamblenë e Përgjithshme të eIFL-net, gjegjësisht të rrjetit botëror të bibliotekave elektronike. E organizuar



nga EIFL-net, OSI, Biblioteka Shkencore – Poznan, Poloni, në këtë Asamble morën pjesë 42 vende të botës. Me këtë rast, u prezantua edhe aktiviteti i BKUK-ës, si pjesëmarrëse e këtij rrjeti. Inaugurimi i Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, gjatë Javës së BKUK- në Kosovë, fitimi i grantit në vlerë prej 8934€, trajnimet dhe punëtoritë nëpër bibliotekat publike të Kosovës dhe në bibliotekat universitare ishin sukseset e paraqitura të aktiviteteteve të eIFL-it në nivel vendor nga Kosova.

SHBA

Drejtori i BKUK - Dr. Sali Bashota, në takimin e tij lamtumirës me Z. Michael McClellan, i cili ka përfunduar misionin e tij në Kosovë, falenderoi Michael McClellan për angazhimin e pakursyeshëm për kontributin e tij dhe të Zyrës Amerikane që ka dhënë gjatë kohës së angazhimit të tij. McClellan, gjithashtu falenderoi Dr. Bashotën për gatishmërinë e treguar lidhur me bashkëpunimin dhe premtoi se një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen me zyren amerikane.

Me rastin e emërimit të shefit të ri të zyrës amerikane në Prishtinë, z. Drejtori i BKUK-së Dr. Sali Bashota i dërgoi një letër përshëndetëse me të cilën i uron mirëseardhje në Kosovë dhe punë të mbarë në detyrën e re - Shef i misionit të Zyrës së SHBA-ve në Kosovë, Phillip Golldberg.

Në letrën e tij përshëndetëse Dr. Bashota deklaroi: “ Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, viteve të fundit ka gëzuar mbështetje të pazëvendësueshme nga Zyra Amerikane e cila ka ndikuar fuqishëm në rritjen e efektivitetit të punës në këtë institucion. Zyra Amerikane në Prishtinë ka dhënë kontribut të pakursyeshëm, vërtet shumë të lartë, shembullor, dhe u angazhua në ndërtimin e një imazhi të ri të këtij institucioni, që do të vlejë edhe në të ardhmen.”

Drejtori i BKUK-së përfundimisht konsideron se niveli i bashkëpunimit dhe miqësisë që gëzon BKUK me Zyrën Amerikane do të mbetet pozitive dhe e prirur për të vazhduar edhe më tutje me këtë normalitet.

Gjermani

Në Berlin, 3 -7 nëntor u mbajt takimi i 32-të me radhë i ISBN-së. 76 përfaqësues të vendeve të ndryshme të botës prezantuan agjencitë e tyre të ISBN-së dhe gjendjen aktuale të tyre. Me këtë rast edhe Agjencia e ISBN-së në Kosovë u prezantua me aktivitetet e saj si dhe me gjendjen e botuesve kosovarë, raportin e tyre me Agjencinë ndërkombëtare etj. E veçantë e këtij takimi ishte pajtimi unanimit që nga viti 2005, të gjitha agjencitë do të paguajnë anëtarësimin e tyre. Ndonëse kishte mjaft polemika lidhur me çështjen e pagesës, sidomos nga UNESCO, Polonia, Greqia, Franca, Holanda, lidhur me kategorizimin e pagesave, Piero Attanasio (ISBN-anëtar i Këshillit Ekzekutiv) shpëgoi se një klasifikim i tillë është bazuar nga statistikat e Bankës Botërore, ku është shikuar ekonomia e çdo vendi. Lidhur me këtë çështje, pagesat do të bëhen nga 250.00 € deri në 18.000 €, ndërkohë që Kosova do të paguajë shifrën më të vogël, do të thotë, 250 € në vit.

Rumani

Aktivisti dhe studiuesi shqiptar, Baki Ymeri, i cili jeton dhe vepron në Rumani, këto ditë i ka dhuruar BKUK-së një fond modest me materiale të vjetra dhe të rralla që i përkasin botimeve kryesisht të edituara në Rumani. Ndër to vlen të veçojmë: Ylli i Shqypperise, Bukuresht 1899, La question albanaise, Dhimitër Berati, e botuar më 1914, Dorëshkrim prej 60 faqesh i jani vretos (1896), Regullorja e Komitetit Shqiptareve për të mprojtur të drejtat kombëtare, Shqipëri, 1911 (1329), dy fotografi – Asdreni me kushririn e tij (1918), Mitrush Kuteli në një ballo bukureshtare (1938) e shumë libra, broshura, revista e letra të ndryshme, të cilat mbledhësi Baku Ymeri nga Bukureshti i ka quajtur Ekspeditimet e para bukureshtare për BKUK.



ISBN

Organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, gjegjësisht nga Agjencia Kombëtare të ISBN-së (Numri Standard Ndërkombëtar i Librit) dhe të ISMN-së (Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës) për Kosovë, këto ditë u mbajt Sesion Informativ, lidhur me rëndësinë e ISBN-së dhe ISMN-së. Ligjërues special i këtij sesioni ishte Drejtori i Agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së dhe ISMN-së - Dr. Hartmut Walravens nga Gjermania. Temat që u diskutuan në këtë sesion ishin: Përparësitë e numrave standardë, ISBN E kaluara dhe e tashmja, Përparësitë e ISBN, Aplikacionet e ISBN, ISBN në botën elektronike, Revizioni i standardit të ISBN-së, ISMN dhe roli i i saj në botën muzikore, ISBN dhe ISMN në rrjetin e identifikueseve bibliografikë.

Dr. Hartmut Walravens, gjatë vizitës së tij në Kosovë zhvilloi takime me përfaqësues të nivelit të lartë. U takua me Ministrin e Kulturës - Mr. Bexhet Brajshorin, Ministrin e Arsmi - Mr. Rexhep Osmanin, me kreun e Fakultetit të Arteve, kryetarin e Shoqatës së Botuesve të Kosovës- Nazmi Rrahmanin, me Parim Kosovën, nga Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me drejtorin e Galerisë së Arteve, Luan Mulliqin, dhe përfundimisht u takua me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës - Akademik Rexhep Ismailin. Qëllimi i këtyre takimeve ishte sensibilizimi i opinionit kosovar për pajisjen e librave dhe veprave tjera të ndryshme me numrat standardë ndërkombëtarë dhe një bashkëpunim i frytshëm i strukturave udhëheqëse kosovare lidhur me depërtimin e librit shqip në botë.

Maqedoni

Qendra e Restaurimit dhe Konservimit e cila rifilloi punën në BKUK, pati vizitë zyrtare njëditore në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Maqedonisë. Me këtë rast, punëtorët e kësaj qendre u pritën nga udhëheqja e Departamentit të Konservimit dhe të Restaurimit në Maqedoni, Z. Jakolevska. Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi lidhur me përvojat e trajtimit të materialit bibliotekar për restaurim dhe konzervim. Duke pasur parasysh përvojat e fituara nga kjo vizitë, punëtorët e Qendrës së Restaurimit dhe Konservimit vlerësuan se krahas mundësive që posedon BKUK-ja, si dhe përvojave profesionale, materialit bibliotekar i duhen trajtime më cilësore të cilat duhet të futen në përdorim menjëherë. SH.R.

Botimet e BKUK-së

Botimet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, të cilave kohëve të fundit po iu jipet rëndësi në këtë institucion, kanë pasur si bazë parimin e mungesave dhe kërkesave themelore që janë shtruar mbrenda këtij institucion. Për këtë arsye edhe pjesa më e madhe e këtyre botimeve shpesh të emëruara si “udhëzues”, japin informacione të shkurtra dhe bazike për probleme të ndryshme për bibliotekën dhe bibliotekarinë në përgjithësi.

EBSCO

EBSCO paraqit informacione të rëndësishme për këtë kompani e cila “qëndron në krye të kompanive të menaxhimit të informacionit elektronik për biblioteka dhe institucione të tjera në të gjithë botën”. Këtu ka informacione që duke filluar prej historikut të kompanisë EBSCO, anëtarësimi dhe deri te mënyra e përdorimit të materialeve elektroniike. Në këtë kompani është realizuar projekt eIFL Direct në të cilin janë anëtarësuar vende të ndryshme që kanë dëshirë ta zgjerojnë funksionin e Bibliotekës dhe ta plotësojnë sa më me sukses kërkesën e lexuesit. Përveç vendeve tjera këtu janë të anëtarësuar edhe Shqipëria dhe Kosova, me çrast ju ka mundësuar edhe lexuesve të interesuar në Kosovë dhe Shqipëri që t'i shfrytëzojnë ato materiale që i ofron kjo kompani. Në këtë manual paraqitet e gjithë rruga që duhet ndjekur për t'i marrë materialet e nevojshme për çdo lexues.



„eIFL.NET“

Një botim tjetër që ndërlidhet me botimin e parë është edhe “Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike të Kosovës, eIFL.net”, ku përfshihet edhe “eIFL Direct project” i EBSCO-s, por edhe shërbime të tjera elektronike në Internet që rrisin diapazonin e informacioneve dhe njohurive të ofruara për lexuesit. Ky është tip i manualit që ofron informacione bazë për qasje në këto informacione që ofron eIFL-a, të rrisin mundësinë e komunikimit sa më të mirë e sa më të suksesshëm të ofruesit të informacioneve me marrësin e tyre. Dhe kështu që të dy librat plotësojnë një vend dhe një kërkesë të madhe edhe pse me informacione të shkurtra, për bashkëpunimin në nivelin elektronik, në atë që ndoshta më vonë do të quhet kibernetikë shqiptare.



“BIBLIOTEKAT DHE LIRIA INTELEKTUALE“

“Bibliotekat dhe liria intelektuale” ka për qëllim ofrimin e informacioneve bazike dhe mjaft shkurtimisht, dhe kjo për vet faktin se problemet që shtjellohen janë në fazën embrionale për bibliotekarinë në Kosovë. Këtu paraqiten objektivat e IFLA/FAIFE-s, organizimi i saj, historiku, synimet, misioni, etj. të këtij komiteti që mbrojnë lirinë intelektuale. “Komiteti i IFLA/FAIFE-s dhe Zyra e tij stimulojnë lirinë e qasjes në informata dhe lirinë e shprehjes në të gjitha aspektet, të cilat në çfarëdo forme janë të lidhura me bibliotekat ose me komunitetin bibliotekar” shkruan ndër të tjera në këtë udhëzues, në të cilin përmbledhet puna e Komitetit IFLA/FAIFE.



“ISBN”

Ndërsa botimi tjetër i ISBN-së është botimi i parë i këtij agjencioni në Kosovë, i cili ka filluar të qarkullojë këtu që 2 vite. Në të ka informacione të rëndësishme për shtëpitë botuese për faktin se për herë të parë para tyre gjendet një libër në të cilin paraqiten shkurtimisht të dhënat e ISBN-së si agjencion ndërkombëtar që vepron në Kosovë për legalizimin e botimeve dhe kontrollimin e tyre përmes numrave që i shpërndan për çdo botim. Këtu përveç informacioneve për ISBN-në, historikut, përdorimit, përparësive të përdoruesve, etj. jipen edhe informacione për të gjitha Shtëpitë Botuese në Kosovë dhe për botuesit privat. Këtu përfshihen emrat e përgjegjësve të Shtëpive Botuese (ose të botuesve privat), adresat e tyre, numrat e telefonit dhe e-mail adresa, si informacione në bazë të të cilave mund të orientohen blerësit apo autorët për blerje apo botim të ndonjë libri.

